

## RAPORT


### I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Për programin e studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi,  
*me profile, a. "Financë- Kontabilitet"; b. "Lidership dhe Menaxhim  
Burimesh Njerëzore"; c. "Marketing dhe Menaxhim Operacionesh"*  
Ofruar nga SHLUJ "Universiteti "Marin Barleti"”**

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof.Asoc. Etleva Leskaj

Dr. Valbona Kapllani



Dhjetor 2018



## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Për Programin e studimit MP në "Administrim Biznesi" me profile, a. "Financë- Kontabilitet"; b. "Leadership dhe Menaxhim Burimesh Njerëzore"; c. "Marketing dhe Menaxhim Operacionesh";**

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Shkolla e Lartë Universitare Jopublike (SHLUJ) "Universiteti "Marin Barleti""
2	Fakulteti që e ofron/Departamenti përgjegjës	Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë <b>Dy Departamente:</b> Departamenti i Ekonomisë dhe Financës dhe Departamenti i Biznes, Menaxhim, Turizëm
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKM Nr. 564, datë 28.05.2009 Leja e ushtrimit të aktivitetit akademik me UMASH, Nr. 259, datë 12.05.2010 Sipas shkresës së MASH Nr. 1167/2 prot, datë 08.06.2011 është bërë riorganizimi i programit nga MND në MP. Profili " <b>Prona të Paluajtshme dhe Sigurime</b> ", nuk është është aktivizuar;
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Urdhër i Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës Nr. 329, datë 07.08.2012 VKA Nr. 357, datë 13.07.2012 (Pozitiv, me rekomandime Profili " <b>Prona të Paluajtshme dhe Sigurime</b> ", nuk është akredituar me UMASH Nr. 329, datë 07.08.2012, sepse nuk është aktivizuar; <i>Profili "Shërbime bankare dhe financiare", që pas akreditimit nuk ka pasur studentë. Ka pasur vetëm një grup studentësh në vitin 2011.</i>
5	Titulli i programit të studimit:	Master Profesional në "Administrim Biznesi" me profile: a. "Financë - Kontabilitet"; b. "Shërbime Bankare dhe Financiare"; c. "Prona të Paluajtshme dhe Sigurimi"; d. "Leadership dhe Menaxhim Burimesh Njerëzore"; e. "Marketing dhe Menaxhim Operacionesh"
6	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit
8	Kreditet në total (ECTS):	60 kredite
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	PO
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	N/A
13	Diplomë e përbashkët Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	N/A
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 7
15	Aktivizimi i programit të studimit	Aktivizimi është bërë në vitin akademik 2011-2012 Profili " <b>Prona të Paluajtshme dhe Sigurime</b> ", nuk është është aktivizuar asnjëherë <i>Profili "Shërbime bankare dhe financiare", është aktivizuar vetëm një vit (2011-2012).</i>
16	Numri i studentëve për vitin 2017-2018	Profili Financë - Kontabilitet 20 studentë Profili Marketing dhe Menaxhim Operacionesh 21 studentë Profili Leadership dhe Menaxhim Burimesh Njerëzore 8 studentë

Shenim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL

## HYRJE

### Të dhëna për programin e studimit Master Profesional me profile

Shkolla e Lartë Universitare Jopublike "Universiteti "Marin Barleti"" (më tej SHLUJ UMB) ka filluar aktivitetin e saj në vitin 2005 mbi bazën e VKM nr. 571, dt. 12.08.2005 "Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare private Marin Barleti", me dy fakultete: Fakulteti i Gjuhëve të Huaja dhe Fakulteti i Matematikës së Zbatuar. Në datë 12.04.2006, me vendimin nr. 2365, Ministria e Arsimit dhe Shkencës miratoi hapjen pranë SHLUJ Universiteti "Marin Barleti" edhe të dy fakulteteve të reja: Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit dhe Fakultetit të Shkencave Humane

Referuar te dhenave ne sistemin e informacionit te ASCAL, programi i studimit qe eshte objekt i ketij procesi akreditimi, është hapur në bazë të VKM Nr. 564, datë 28.05.2009 dhe të Urdhërit Nr. 259, datë 12.05.2010 të Ministrisë të Arsimit dhe të Shkencës. Sipas VKM Nr. 564, në mbarim të programit të studimit lëshohet diploma "Master i nivelit të dytë" (MND) . [Evidence, Vendim Për hapjen e programeve të reja të studimit MND në ShLUP UMB].

Mbeshtetur mbi te dhenat e siguruar nga sistemi i informacionit te ASCAL, ky program studimi ka marre lejen e ushtrimit te aktivitetit akademik, me Urdher te MASH nr. 259, date 12.05.2010. Sipas shkresës së MASH Nr. 1167/2 prot, datë 08.06.2011, eshte bere pershtatja e ketij programi studimi në MNP [Evidence, Shkresë Shkresë e MAS drejtuar Marin Barletit në lidhje me disa programe, viti 2011]

Programi i Studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi", eshte akredituar per here te pare me vendim te Këshillit të Akreditimit, Nr. 357, datë 13.07.2012. Ne kete vendim paraqiten dhe rekomandimet e lena per cdo profil te ketij programi.

Programi Master Profesional në "Administrim Biznesi" me profile, te cilit ne vijim te ketij raporti, do t'i referohemi si PS MP AB me profile<sup>1</sup>, eshte aktivizuar ne vitin akademik 2011-2012 per here te pare. Profili "Prona të Paluajtshme dhe Sigurime", nuk është është aktivizuar asnjëherë, ndersa profili "Shërbime bankare dhe financiare", është aktivizuar vetëm një vit 2011-2012, ndersa gjate viteve te tjera nuk ka pasur studente te rregjistruar. Per sa me siper, GVJ ne vazhdim te ketij raporti te vleresimit te jashtem, do te analizoje vetem tre profile, "Financë-Kontabilitet"; "Lidership dhe Menaxhim Burimesh Njerëzore" dhe "Marketing dhe Menaxhim Operacionesh".

### GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

Prof.Asoc. Etleva Leskaj

Dr.Valbona Kapllani

Koordinatorë teknikë në këtë procedurë nga ASCAL, janë specialistët R. Qatipi dhe E. Xhako.

Më datë 02.12.2018 SHLUJ "Universiteti M. Barleti" është njohur me Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për këtë program studimi, nëpërmjet sistemit AMS. Draft RVJ është dërguar zyrtarisht, me shkresë Nr. 113/16 Prot., datë 03.12.2018 "Dërgohet Draft Raporti i vlerësimit të jashtëm".

SHLUJ "Universiteti M. Barleti" ka sjellë përgjigje me shkresë Nr. 2411, datë 06.12.2018 "Kihim përgjigje mbi draft raportin e vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit "MP. Administrim Biznesi, me profile".

GVJ pasi u njoh me komentet e percjella nga institucioni ne lidhje me raportin e GVJ, per PS MP ne AB me profile vendosi:

<sup>1</sup> PS MP AB -Programi i Studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi"

1. *Për komentin e pare të institucionit, "Në lidhje me konstatimin për numrin e lëndëve për stafin akademik me kohë të plotë cituar në RVJ (fq. 4, 5, 17, 18)":* GVJ pasi vlerësoi objeksionin e paraqitur nga institucioni, mbetet e mendimit që SHLUJ "Universiteti "Marin Barleti"" për programin e studimeve Master Profesional në "Administrim Biznesi" me profile, ne te ardhmen të vlerësojë mundësinë e uljes së numrit të lëndëve që mbulon çdo pedagog te cilat aktualisht janë deri ne 7 lende/pedagog, e cila nga GVJ cilësohet me impakt jo pozitiv, mbi cilësinë e mësimdhënies. Kjo do te siguronte një përdorim efektiv te burimeve njerezore, si dhe do te siguronte një ekuilibër me te mire mes objektivave të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe aktiviteteve administrative që stafi mbulon. *Per sa me siper GVJ I mbetet te njejtit qendrim si ne draft RVJ.*

2. *Per komentin e dyte te institucionit, "Në lidhje me konstatimin për përputhshmërinë mes kualifikimit dhe lëndëve që ofrohen (RVJ fq. 4, 5 17, 18, 27)",*

GVJ vlerëson objeksionin e paraqitur nga institucioni, por i qëndron te njëjtit vlerësim te dhene ne draft RVJ. GVJ ne gjykimin e saj nuk i eshte referuar fushës se ngushte te ekspertizës. Referuar CV te stafit si dhe dokumentit te shpërndarjes se ngarkesës konstaton rast kur pedagog i perfshire ne mësimdhënie ne PS MP AB, përveçse jep 7 lende te ndryshme, ato përfshijnë, makroekonomi, ekonometri (2 lende ekonomiksi), Manaxhim i burimeve njerezore si dhe Manaxhim Shperblimi (2 lende manaxhimi), Sistem Bankar dhe Financiar, Taksim, Legjislacion Tatimor (3 lende te financës), nderkohe qe formimi i tij eshte i fushës se ekonomiksit.

3. *Per komentin e trete, " Në lidhje me konstatimin për mbulimin me staf të brendshëm (RVJ fq 4, 5, 11, 12 dhe 18)",* GVJ pranon pjeserisht objeksionin e paraqitur nga institucioni.

Referuar planeve mesimore dhe peshës se krediteve te mbuluara nga stafi akademik efektiv per te tre profilet, te vendosur nga institucioni ne dispozicion ne fazën e paraqitjes se objeksioneve rezuton se:

- Per profilin "Finance-Kontabilitet", per tre vitet e para, 38,3 % e krediteve qe plani mësimor i këtij profili përmban mbulohen nga staf efektiv. Per tre vitet e fundit te periudhës se akreditimit, kjo norme eshte 71.7%, 80%, 71,7%.
- Per Profilin "Lidership dhe Manaxhim Burimesh Njerezore", per dy vitet e para 58,3 % e krediteve qe plani mësimor i këtij profili përmban mbulohen nga staf efektiv. Per 4 vitet e fundit, kjo norme eshte ne intervalin 75% - 91.7%.
- Per profilin "Marketing dhe Manaxhim Operacionesh", pesha e krediteve te mbuluara nga stafi akademik efektiv për te gjithë periudhën e akreditimit është mbi 75%.

GVJ ne draft RVJ e paraqitur ne institucion i është referuar numrit te stafit te përfshire ne mësimdhënie ne këto profile, dhe raportit PAE/PAK qe rezulton nga kjo përfshirje, dhe jo peshës se krediteve respektive te mbuluara nga dy kategoritë e stafit akademik. Ndërkohe referuar analizës se peshës se krediteve te mbuluara nga stafi efektiv ne këto profile rezulton se ne profilin Marketing dhe Manaxhim Operacionesh", pesha e krediteve te mbuluara nga stafi akademik efektiv per te gjithë periudhën e akreditimit është mbi 75%, ndërsa ne profilin "Lidership dhe Manaxhim Burimesh Njerezore", dy vite e para kjo norme është nen 70%, ndërsa profilin "Finance-Kontabilitet" tre vitet e para kjo norme është nen 70%.

*Persa me siper GVJ, merr parasysh pjeserisht komentin e institucionit, dhe i ka paraqitur këto te dhena ne RVJ final, por edhe kjo mënyre llogaritje pavarësisht përmirësimeve te vlerësueshme qe institucioni ka bere ne rritjen e peshës se krediteve te mbuluara nga stafi efektiv, nuk e ndryshon nivelin e përmbushjes se standardit respektiv, pasi ne tre vitet e para ne profilin Finance-Kontabilitet dhe ne dy vitet e para ne profilin Lidership dhe Manaxhim Burimesh Njerezore, kane qene nen 70%, përveç konstatimeve për numrin e personelit akademik efektiv te prezantuar qe ne fazën e draft RVJ.*

4. *Për komentin e katert, "Në lidhje me harmonizimin dhe rakordimin e veprimtarive të strukturave të sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit të performancës me qëllim shmangien e mbivendosjes së funksioneve dhe sigurimit të një vlerësimi të plotë në nivel program studimi duke përdorur mekanizma të diversifikuar dhe efektive (RVJ fq 25 dhe 26)",* GVJ vlereson iniciativat e institucionit per te konsoliduar sistemin e Sigurimit

te brendshem te cilesise, por sikurse dhe paraqitet ne objeksionin e institucionit, keto iniciativa jane ndermarre ne 2017 dhe efektet e tyre do te duken ne vitet ne vijim.

*Per sa me siper GVJ i qendron te njejtit vleresim.*

5. *Në lidhje me konstatimin e eksperteve në lidhje me praktikën e publikimit të broshurave apo buletineve për vlerësim nga institucioni dhe publikime të strategjisë, politikave e procedurave për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë...(RVJ fq. 26).*

Elementet që institucioni raporton, se përdor në përbushje të kriterëve të këtij standardi dhe që paraqiten në objeksionin e kësaj pike, janë marrë parasysh nga GVJ gjatë hartimit të draft raportit, prandaj edhe standardi është konsideruar kryesisht i përbushur. Nderkohe që sikurse dhe kriteret respektive e shprehin, kërkohen praktikën e publikimit të broshurave dhe buletineve rreth vlerësimit të brendshëm, për të cilat GVJ nuk siguroi informacion, dhe që do t'i shërbenin përbushjes së kriterëve në mënyrë të drejtpërdrejtë.

*Per sa me siper, GVJ ka te njejtin qendrim sikurse ne draft RVJ*

6. *Komenti nr. 6 "Në lidhje me konstatimin e eksperteve për mungesën e një studimi specifik tregu të kryer posacerisht për nevojat e këtij programi studimi (RVJ fq 30); theksojmë se si edhe janë shprehur drejtuesit e njësive kryesore dhe bazë gjatë takimit në Institutin me GVJ të tre profilet e këtij programi studimi në thelb nuk e kanë të nevojshme një studim të mirëfilltë tregu pasi çdo sipërmarrje që të funksionojë e ka të nevojshëm një specialist finance dhe një menaxher. etj". Në lidhje me komentin nr.6 mbi konstatimin tonë se mungon një studim specifik tregu, të kryer posacerisht për nevojat e këtij programi studimi (RVJ fq 30) vlerësimi ynë si GVJ nuk ndryshon pasi ky është tashmë një fakt. Shkalla e përbushjes së standardeve I.7 & I.8 është vlerësuar si "të përbushur kryesisht" sepse kemi marrë në konsideratë studimet e tjera të bëra në vite dhe të vëna në dispozicion nga IAL.*

## **ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË**

### **I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit**

**Për programin e studimit "Master Profesional në Administrim Biznesi me profil: Financë Kontabilitet".**

- a. Të realizohet përmirësimi i menjëhershëm i raportit pedagog i brendshëm/ pedagog i jashtëm.
- b. Fakulteti/Departamenti duhet të shoh me përparësi përfshirjen e stafit të brendshëm të kualifikuar në organizimin e këtij programi studimi.
- c. Të rishikohen disa syllabuse në mënyrë që literatura bazë apo ndihmëse të jenë të up-datuara sipas kërkesave bashkohore.
- d. Të rishikohet rregullorja e provimeve, ku provimet të mos korrigjohen të pa sekretuara dhe vetëm nga një pedagog i cili është titullar i lëndës.
- e. Institucioni duhet të ketë në prioritetet dhe strategjitë e tij afatmesme, kërkimin shkencor, në mënyrë që të kompletojë stafin akademik të brendshëm në proceset e kualifikimit në mënyrë që brenda një kohe të shkurtër ky staf të përfshihet në procesin e mësimdhënies.
- f. Të synohet botimi i një reviste/buletini shkencor si edhe të aplikohen mënyra nxitëse ndaj stafit për botime shkencore dhe aktivitete shkencore si seminare dhe konferenca për gjallërimin e jetës shkecore si edhe ngritjes nga kjo edhe të kualifikimit e cilësisë së mësimdhënies.
- g. Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

**Për programin e studimit “Master Profesional në Administrim Biznesi me profile: Marketing dhe Menaxhim Operacionesh; Lidership dhe Menaxhim burimesh njerëzore”.**

- a. Të krijohen mundësia për akses në biblioteka elektronike për të siguruar suport për kërkim shkencor cilësor.
- b. Të përmirësohet raporti pedagog efektiv/pedagoge të jashtëm.
- c. Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

## **II. PLOTËSIMI I TYRE NGA INSTITUCIONI**

### **Për programin e studimit “Master Profesional në Administrim Biznesi ne profilin Finance-Kontabilitet**

- a. **Ne lidhje me rekomandimin e pare,** Referuar RVB raporton se 71.7% e ngarkeses ne mesimdhënie te ketij programi mbulohen nga stafi efektiv. Pavaresisht ngarkeses se larte qe mbulon stafi efektiv ne kete program, vihet re se kjo perkthehet dhe ne numer te 3 [lendesh per pedagoget efektiv, duke arritur mesatarisht ne 6 lende per pedagoge, ku identifikohen edhe raste te pedagoqeve qe mbulojne 7 lende, ne programe te ndryshme studimore dhe nivele te ndryshme. Gjithashtu vihet re se jo gjithmone ka përputhshmeri mes fushes se ekspertizes dhe lendeve qe mbulojne. Nga analiza e te dhenave qe raportin institucioni, **per profilin Finance-Kontabilitet** GVJ konstaton se gjate gjithe periudhës per te cilën akreditohet ky program studimi, stafi efektiv i perfshire ka qenë ne intervalin 11% - 67% e stafit te angazhuar ne mësimdhënie. Nga sa me sipër GVJ eshte e mendimit se pavarësisht se UMB ka rritur mbulimin e mësimdhënies ne PS MP AB ne këte profil, kjo duhej shoqëruar me rritje te numrit te stafit efektiv dhe jo vetëm me rritjen e ngarkesës se stafit efektiv. Keshtu per vitet, 2012-2013, 2013-2014, 2014-2015, rezulton se vetëm 1 anetare i stafit akademik ne kete program ka qene personel efektiv. **GVJ konkludon se ky rekomandim eshte pjesërisht i përmbushur**
- b. Per rekomandimin b, institucioni ka rritur numrin e pedagoqeve te brendshëm te kualifikuar, por e lidhur kjo me rekomandimin a., kjo përfshirje dhe rekrutimi i këtyre stafëve duhej te ishte ne nivele me te larta. **GVJ konkludon qe ky rekomandim eshte kryesisht i përmbushur.**
- c. Në lidhje me rekomandimin c, GVJ referuar RVB por edhe takimeve me pedagogë të programit të studimit, konkludon se syllabuset jane rishikuar dhe plotësuar sipas kërkesave bashkëkohore. Në secilin syllabus identifikohet qartë informacioni i përgjithshëm, objektivat dhe rezultatet e pritshme, konceptet kryesore dhe temat e parashikuara, forma e kontrollit të dijeve, literatura e detyrueshme dhe plotësuese (e rekomanduara). **GVJ e konsideron kete rekomandim te përmbushur.**
- d. Ne lidhje me kete rekomandim, GVJ referuar RVB por edhe takimeve me studente te profilit si dhe me pedagoge te programit, konkludon se provimet zhvillohen te sekretuara, duke rritur objektivizmin ne korrigjim. **GVJ e konsideron këtë rekomandim të përmbushur.**
- e. Edhe plotesimi i rekomandimit e, është i lidhur me rekomandimet a & b. Konkretisht gjatë harkut kohor në analizë institucioni ka rritur numrin e pedagoqeve te brendshëm te kualifikuar, por kjo përfshirje dhe rekrutimi i këtyre stafëve duhej te ishte ne nivele me te larta. **GVJ konkludon që ky rekomandim është kryesisht i përmbushur.**
- f. Përsa i takon rekomandimit f, GVJ referuar RVB por edhe takimeve me pedagogët konstatoi se institucioni mbështet pjesëmarrjen në aktivitete shkencore, seminare dhe konferenca, nëpërmjet politikës së sponsorizimit të pjesshëm apo të plotë pas një vlerësimi nga strukturat përgjegjëse rast pas rasti. **GVJ e konsideron këtë rekomandim të përmbushur.**
- g. Rekomandimi i fundit, ne kushtet e ndryshimeve ne aktet ligjore dhe nenligjore, nuk eshte me detyrues per IAL.

**Për programin e studimit “Master Profesional në Administrim Biznesi me profile: Marketing dhe Menaxhim Operacionesh; Lidership dhe Menaxhim burimesh njerëzore”.**

- a. Për rekomandimin a, GVJ nga vizita ne institucion konstaton se institucioni ka ndermarre masat e duhura per pasurimin e bibliotekes jo vetem me libra, revista shkencore dhe periodike hard-copy, por edhe mundesi te shfrytezimit te bibliotekes elektronike te institucionit ne intranetin e UMB, si dhe ka siguruar edhe akses ne biblioteka elektronike, si ajo e Oregon University. **GVJ konkludon se ky rekomandim eshte permbushur.**
- b. Për rekomandimin B, referuar RVB raporton se 91.7% e ngarkeses ne mesimdhënie te ketij programi mbulohen nga stafi efektiv. Pavaresisht ngarkeses se larte qe mbulon stafi efektiv, vihet re se kjo perkthehet dhe ne numer te larte lendesh per pedagoget efektiv, duke arritur mesatarisht ne 6 lende per pedagoge, ku identifikohen edhe raste te pedagogeve qe mbulojne 7 lende, ne programe te ndryshme studimore dhe nivele te ndryshme. Gjithashtu nga vihet re se jo gjithmone ka perputhshmeri mes fushes se ekspertizes dhe lendeve qe mbuljne.

GVJ nga analiza e te dhenave qe raporton institucioni, konkludon se **per profilin MKT dhe MO** per vitet 2017-2018 dhe 2015-2016, stafi efektiv ka qenë mbi 70% e stafit e te perfshire ne mesimdhënie, per gjithë vitet e tjera te periudhës se akreditimit, kjo normë ka qenë në intervalin 38%-63%.

**Per profilin Lidership dhe Manaxhim Burimeve Njerezore**, per vitet 2017-2018, 2016-2017 dhe 2015-2016, stafi efektiv ka qenë 100% e stafit te perfshire ne program. Për vitet e tjera te periudhes se akreditimit, kjo normë ka qenë në intervalin 50%-67%. Nga sa me sipër GVJ eshte e mendimit se pavarësisht se UMB ka rritur mbulimin e mesimdhënies ne PS MP AB ne këto dy profile, kjo duhej shoqëruar me rritje te numrit te stafit efektiv dhe jo vetëm me rritjen e ngarkesës se stafit efektiv.

**GVJ konkludon se ky rekomandim eshte pjesërisht i përmbushur**

- c. Rekomandimi c, ne kushtet e ndryshimeve ne aktet ligjore dhe nenligjore, nuk eshte me detyrues per IAL.

## 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

### Pjesa përshkrimore

*Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.*

Programi i studimit MP ne "Administrim Biznesi" me profile, "Financë- Kontabilitet"; "Lidership dhe Menaxhim Burimesh Njerëzore"; "Marketing dhe Menaxhim Operacionesh" pjese e programeve te studimit te SHLUJ "Universiteti "Marin Barleti", implementohet nga dy departamente, Departamenti i Ekonomise dhe Finances si dhe Departamenti i Biznes, Menaxhim, Turizem, te cilet jane njesi baze te Fakultetit te Shkencave te Aplikuara dhe Ekonomise.

GVJ, referuar RVB si dhe nenit 3 te rregullores se ketij programi Master Profesional, konstaton se misioni i programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi" [Evidence 7. Rregullore e programit te studimit.pdf, DVV], eshte:

*"Zhvillimet dinamike të Shek.XXI krijuan në treg nevojën për një qasje shkencore ndaj menaxhimit. Programi i Masterit në Administrim Biznesi, synon të mbulojë fusha të ndryshme të biznesit në një mënyrë relevante të analizës menaxheriale dhe strategjike. Nisur nga specifikat e tregut të punës në vendin tonë dhe në përputhje me strategjitë dhe misionin e Institucionit tonë, programi ofron profile specializimi profesionale në FinancëKontabilitet, Shërbime Bankare e Financiare, Marketing dhe Menaxhim Operacionesh, Lidership dhe Menaxhim Burime Njerëzore, Prona të Paluajtshme dhe Sigurime".*

GVJ, referuar rregullores se PS MP ne Administrim Biznesi me profile, konstaton se jane te deklaruar per cdo profil te ketij programi master, misioni i profilit, objektivat e profilit te studimit, kompetencat e pergjithshme, kompetencat specifike si dhe kompetencat e transferueshme me te cilat synohet qe te pajisen te diplomuarit e ardhshem ne profilet respektive.

Gjithashtu GVJ konstaton nga RVB se UMB, ka te deklaruar vizionin e institucionit, i cili lidhet me shenderrimin e UMB ne nje universitet te nivelit te larte duke bashkuar edukimin demokratik dhe liberal me shpirtin e sipermarrjes ne gjithcka qe ata bejne. Ndersa referuar misionit te institucionit, ai eshte: "Forcimi i trashëgimisë dhe reputacionit në drejtim të përpjekjeve shkencore për të krijuar një model të arsimit të lartë që kombinon standardet akademike me aplikimet e botës reale".

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;	GVJ konstaton se programi i studimit, "Master Profesional në Administrim Biznesi" me profile, pranë UMB, është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit.
<b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	GVJ, referuar RVB si dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, vlerëson se programi i studimit MP në AB me profile, hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.
<b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes se vetevleresimit, konstatohet se UMB ben nje analize te te diplomuarve ne vite ne profilet e ketij masteri, si dhe te punesimit te ketyre te diplomuarve dhe duke e pare propabilitetin e larte te punesimit te te diplomuarve ne keto profile si tregues te perputhshmerise me nevojat e e tregut te punes [Evidence 2. ix. Analize e
<b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	



	<p><i>studimit te tregut.pdf, Dosja vetevleresimit]</i></p> <p>Programi i studimit, MPAB me profile, është hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit. GVJ eshte e mendimit se PS MPAB paraqitet thellesisht i diversifikuar duke qenë, se synon aftesimin e studentëve ne 5 fusha specifike të tregut të punës, me synimin për t'iu përshtatur kërkesave të këtij tregu dhe per t'i ofruar ketij tregu administratore biznesi te profileve te ndryshme. <i>[Evidence 2. iii Plani mesimor LMBNJ.pdf, Dosja e vetevleresimit]</i></p> <p>Programi i studimit MPAB, me profile, pranë UMB, pasqyron vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit dhe ka pajtueshmeri te plote me keto vlera</p>
<p><b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Ne lidhje me kete kriter, referuar RVB, PS MPAB me profile prane UMB, eshte pershtatur me strategjine per zhvillim te institucionit.</p>
<p><b>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>GVJ mbështet mendimin se përmbajtja e programit të studimit MP në Administrim Biznesi, pranë UMB, është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi. Programi zbaton kërkesat e akteve rregullatore të institucionit, në formën e rregulloreve dhe udhëzimeve të përgjithshme dhe specifike për programin. <i>[Dokumenti 7. Rregullore e programit te studimit.pdf etj; Dosja e vetevleresimit]</i></p> <p>Emërtimi i programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi" me profile: a. "Financë - Kontabilitet"; b. "Shërbime Bankare dhe Financiare"; c. "Prona të Paluajtshme dhe Sigurimi"; d. "Lidership dhe Menaxhim Burimesh Njerëzore"; e. "Marketing dhe Menaxhim Operacionesh", është në përputhje me orientimet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimit sipas nivelit 7 të kësaj kornize.</p>
<p><b>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Sipas informacionit të siguruar nga RVB, nga takimi i GVJ me titullarin e institucionit, me drejtues te njesise kryesore, dhe ne sistemin e ASCAL, ka një plan strategjik për zhvillimin e programeve të studimeve, si dhe per permiresimin e rezultateve te mesimdhënies dhe te te nxënit. <i>[Evidence, Aneks/Shtojce Platforma e Zhvillimit Strategjik, MP. Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, SHLUJ Universiteti Marin Barleti]</i></p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p>GVJ nga analiza e dokumentacionit ne dispozicion dhe te cituar gjate analizes se standardeve per kete fushe vleresimi, konkludon se:</p> <p>PS MP AB me profile, eshte në përputhje me misionin dhe qëllimin e qe Shkolla e Lartë Universitare</p>	

Jopublike (SHLUJ) "Universiteti "Marin Barleti"" ka.

PS MP AB me profile, ofrohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Programi i studimit në shqyrtim synon ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe ofron informacion të plotë në lidhje me çdo element të rëndësishëm të tij.

Referuar misionit të PS MP AB me profile, si dhe planit mesimor të tre profileve të marra në shqyrtim, konstatohet se ky mision është i arritshëm nepermjet implementimit të strategjise së institucionit dhe bashkëpunimit të stafit akademik, stafit administrativ, strukturave drejtuese dhe studenteve të programit.

## 2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

### Pjesa përshkrimore

*Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit*

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë (FSHAE), pjesë integrale e të cilit janë edhe dy njesite baze përgjegjese për PS MPAB me profile, ka në përberje tre departamente: Departamenti i Arkitekturës dhe Shkencave Kompjuterike, Departamenti Biznes, Menaxhim e Turizëm, Departamenti i Ekonomisë dhe Financës.

**Departamenti i Arkitekturës dhe Shkencave Kompjuterike** siguron arsimimin e lartë dhe kërkimin shkencor në fushën e arkitekturës, urbanistikës, shkencave kompjuterike dhe teknologjisë së informacionit.

**Departamenti Biznes, Menaxhim e Turizëm** i cili në programet e studimit që ofron, synon përgatitjen e menaxhereve dhe punonjësve të ardhshëm në fushën e biznesit dhe të turizmit.

**Departamenti i Ekonomisë dhe Financës** ofron programe studimore që synojnë të përgatisin specialistë për një karrierë të ardhshme si ekspertë kontabël, financiarë, apo analistë financash të institucioneve të ndryshme private apo publike, të tillë që në të ardhmen të mund të thellojnë studimet apo të specializohen për financat e shtetit, për bursën, për tregjet e sigurimeve etj.

Departamenti i Biznes, Menaxhim e Turizem dhe Departamenti i Ekonomise dhe Finances, janë dy departamentet përgjegjese për PS MPAB me profile. Departamenti i Biznes, Menaxhim e Turizem është përgjegjës për implementimin e profileve, ndërsa "Lidership dhe Menaxhim Burimesh Njerëzore"; dhe "Marketing dhe Menaxhim Operacionesh", Departamenti i Ekonomise dhe Finances është përgjegjës për implementimin e profilit "Financë - Kontabilitet"

Pranë Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë operon Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit "Barleti" i cili është krijuar në 2009 dhe që operon me qëllim jofitimor.

GVJ referuar vizitës në UMB, konstatoi se FSHAE, që është fakulteti përgjegjës për PS MPAB me profile, ka në përberje të tij, një personel akademik të përbërë nga 51 anëtarë të personelit akademik efektiv dhe me kontratë. Staf i administrativ është i organizuar në nivel institucioni në dy struktura: për programet bachelor dhe për programet master. Personel akademik efektiv janë gjithsej 26 persona, nga të cilët 58% janë personel akademik me grada dhe tituj. Personel akademik me kontratë janë 25 persona, ndër të cilët 52% janë me grada dhe tituj. [Aneks Tabela 1]

Stafi administrativ është i organizuar në nivel institucioni në dy struktura: për programet bachelor dhe për programet master.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura akademike e Fakultetit

Dekani është autoriteti drejtues në secilin prej fakulteteve të Universitetit. Strukturat përbërëse të Universitetit janë njësitë kryesore, njësitë bazë dhe njësi të tjera të ngritura pranë universitetit dhe të përcaktuara në statut.

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë pranë UMB aktualisht ka tre departamente dhe një institut kërkimor: Departamenti i Arkitekturës dhe Shkencave Kompjuterike, Departamenti Biznes, Menaxhim e Turizëm, Departamenti i Ekonomisë dhe Financës si dhe Instituti i Kërkim Zhvillimit “Barleti”

Dy departamentet përgjegjës për programin e studimit bashkërendojnë aktivitetet e tyre, për të garantuar implementimin e PS MP AB.

GVJ referuar strukturës akademike, mendon se kjo strukturë është në funksion të plotë të programit të studimit, të përmbushjes së objektivave si dhe të implementimit të strategjisë që institucioni ka për këtë programi studimi

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

GVJ nga të dhënat e siguruar nga RVB, konstaton se stafi akademik i departamenteve përgjegjëse për PS MP AB është si me poshtë:

**Departamenti Biznes, Menaxhim e Turizëm**, përbëhet nga 9 anëtarë, nga të cilët 7 janë staf akademik efektiv, prej të cilëve 2 mbajnë titullin Prof.Asoc dhe 4 pedagogë kanë gradën Dr. Stafit joefektiv përbëhet prej 2 anëtarëve të cilët janë me grada ose tituj akademike. Të dhënat për stafin akademik të departamentit të Ekonomisë dhe Financës, paraqiten në Tabelën 2, në shtojcë.

**Departamenti i Ekonomisë dhe Financës** përbehet nga 16 anetare të stafit akademik. 50% e stafit akademik të këtij departamenti, janë staf akademik efektiv. Në përberje të stafit efektiv rezultojnë, 3 anetare janë me gradën shkencore Dr, 3 anetare të kategorisë Profesorë dhe 2 prej tyre pa grade [Tabela 1 dhe 3, Aneks]

Stafi joefektiv ka në përberje 8 pedagogë, ndër të cilët 2 janë të kategorisë Profesor, 5 mbajnë grade shkencore Dr, dhe 1 prej tyre pa grade. [Tabela 1, Aneks]. GVJ gjatë vizitës në institucion nuk konstatoi ndryshime nga të dhënat e referuara në RVB.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Tabelat e raportit të RVB në word.pdf – Dokumenti 39 nga Vizita në institucion.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Departamenti duhet të ketë në përberje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>GVJ është e mendimit se struktura organizative e UMB mbështet plotësimin e misionit të institucionit.</p> <p>GVJ nga informacioni i siguruar në institucion, nga RVB si dhe nga web siti zyrtar i IAL, konstaton se UMB në përberje të tij ka 2 Fakultete, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë dhe Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike</p> <p>GVJ referuar struktues akademike të UMB, në web sitin e saj, konstaton se Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë përbëhet nga tre njësi baze: Departamenti i Arkitekturës dhe Shkencave Kompjuterike, Departamenti Biznes, Menaxhim e Turizëm, Departamenti i Ekonomisë dhe Financës.</p> <p>GVJ konstaton se njesite kryesore, njesite baze dhe programi i studimit, që është objekt i këtij procesi akreditimi, kanë të</p>

	<p>deklaruar misionin si dhe objektivat ne permbushje te ketij misioni</p> <p>GVJ nga analiza e perberjes se Departamenti Biznes, Menaxhim e Turizëm, konstaton se kjo njësi baze perbehet nga 9 anëtarë, nga të cilët 7 janë staf akademik efektiv, prej të cilëve 2 mbajne titullin prof./asoc dhe 4 gradën doktor. GVJ konkludon se Departamenti i Ekonomisë dhe Financës ka ne perberje 8 pedagoge efektive, nder te cilet 3 anetare jane me graden shkencore, 3 anetare te kategorise profesore dhe 2 prej tyre pa grade. [Evidence, Tabela 3 bashkelidhur]</p>
<p><b>Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Duke iu referuar vizites ne institucion, me drejtues te njesive baze, asaj kryesore si dhe me stafin akademik te te dy departamenteve, rezulton se këto struktura janë të ndërgjegjshme për realizimin e PS MPAB me profile.</p> <p>Nga informacioni i siguruar ne institucion, rezulton se njesite baze kane rol te rendesishem ne iniciimin e vendimeve te ndryshme, ne ndryshimin e kurrikules per pershtatje me tregun, ndryshimin e syllabuseve etj. [Evidence, Procedura e ndryshimit te planit mesimor.pdf; Procedure pasurimi i bibliotekes.pdf; Shembuj ndryshim silabusesh ne vite.pdf, Vizita ne institucion]</p> <p>Referuar takimit me drejtuesen e njesisë kryesore dhe drejtuesit e njësive baze, qe janë pergjegjes per kete program studimi, si dhe me përfaqësuesen e zyrës së burimeve njerëzore, rezulton se njësitë bazë dhe njësia kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm. [Evidence, Proces rekrutimi Sh.C.pdf]</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Njesia kryesore, njesite baze pergjegjese per programin si dhe PS MP AB me profile, qe eshte objekt i ketij procesi akreditimi, kane te deklaruar misionin si dhe objektivat ne permbushje te misionit</li> <li>- Programi i studimit MP ne AB është në përputhje me strategjinë për zhvillim të UMB</li> <li>- Programi i studimeve MP AB me profile, ofrohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, statutin e institucionit dhe rregulloren e PS</li> <li>- Njesite baze plotesojne kerkesat ligjore per perberjen sasiore dhe cilesore te stafit akademik.</li> </ul>	

### 3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

#### Pjesa përshkrimore

*Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës*

*për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.*

Stafi akademik i programit të studimit MP AB me profile për vitin 2017-2018 përbehet nga 20 pedagoge, ndër të cilët 14 janë pedagoge efektive dhe 6 janë staf joefektiv. Stafit me tituj dhe grada, varion në profile të ndryshme nga 75%-100% e stafit të angazhuar në mësimdhënie. Kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë të deklaruara në Statut për strukturat drejtuese, nën 28-30 të Statutit, ndërsa për stafin tjetër sipas nënit 23 të Statutit të UMB.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat.**

Te dhënat për personelin akademik dhe me kontratë për programin “Master Profesional” në “Administrim Biznesi”, paraqiten në Tabelen 4, shtojca bashkëlidhur, sipas profileve:

**Per profilin Finance-Kontabilitet** nga analiza e të dhënave për stafin akademik të përfshirë në mësimdhënie gjatë viteve 2012-2018, rezultojnë si më poshtë [Tabela 5, Aneks]

- për vitin 2017-2018, personeli akademik përbehet nga 8 pedagogë, nga të cilët 4 PAE dhe 4 PAK (50%/50%)
- për vitin 2016-2017, personeli akademik përbehet nga 9 pedagogë, nga të cilët 6 PAE dhe 3 PAK (67%/33%)
- për vitin 2015-2016, personeli akademik përbehet nga 8 pedagogë, nga të cilët 4 PAE dhe 4 PAK (50%/50%)
- për vitin 2014-2015, personeli akademik përbehet nga 9 pedagogë, nga të cilët 1 PAE dhe 8 PAK (11%/89%)
- për vitin 2013-2014, personeli akademik përbehet nga 8 pedagogë, nga të cilët 1 PAE dhe 7 PAK (13%/87%)
- për vitin 2012-2013, personeli akademik përbehet nga 8 pedagogë, nga të cilët 1 PAE dhe 7 PAK (13%/87%)

Referuar shifrave të mësipërme, GVJ konstaton se gjatë gjithë periudhës për të cilën akreditohet ky program studimi, për profilin Finance-Kontabilitet, stafi efektiv ka qenë nën normën 70%. Kjo normë ka qenë në intervalin 11%-67%.

Referuar planeve mesimore dhe peshës së krediteve të mbuluara nga stafi akademik efektiv për profilin “Finance-Kontabilitet”, për tre vitet e para, 38,3 % e krediteve që plani mësimor i këtij profili përmban mbulohen nga staf efektiv. Për tre vitet e fundit të periudhës së akreditimit, kjo normë është 71,7%, 80%, 71,7%.

**Per profilin Marketing dhe Manaxhim Operacionesh** nga analiza e të dhënave për stafin akademik të përfshirë në mësimdhënie gjatë viteve 2012-2018, rezultojnë si më poshtë [Tabela 6, Aneks]:

- për vitin 2017-2018, personeli akademik përbehet nga 4 pedagogë, nga të cilët 4 PAE dhe 0 PAK (100%/0%)
- për vitin 2016-2017, personeli akademik përbehet nga 4 pedagogë, nga të cilët 4 PAE dhe 0 PAK (100%/0%)
- për vitin 2015-2016, personeli akademik përbehet nga 4 pedagogë, nga të cilët 4 PAE dhe 0 PAK (100%/0%)

- për vitin **2014-2015**, personeli akademik përbëhet nga 6 pedagogë, nga të cilët **4 PAE dhe 2 PAK (67%/33%)**
- për vitin **2013-2014**, personeli akademik përbëhet nga 6 pedagogë, nga të cilët **3 PAE dhe 3 PAK (50%/50%)**
- për vitin **2012-2013**, personeli akademik përbëhet nga 6 pedagogë, nga të cilët **3 PAE dhe 3 PAK (50%/50%)**

Gjatë periudhës 2012-2018, për vitet 2017-2018, 2016-2017 dhe 2015-2016 stafi efektiv ka qenë 100% e stafit të përfshirë në program. Për gjithë vitet e tjera kjo normë ka qenë në intervalin 50%-67%.

Referuar planeve mesimore dhe peshës së krediteve të mbuluara nga stafi akademik efektiv për profilin "Marketing dhe Manaxhim Operacionesh", peshën e krediteve të mbuluara nga stafi akademik efektiv për të gjithë periudhën e akreditimit është mbi 75%.

**Per profilin Liderhip dhe MBNJ** nga analiza e të dhënave për stafin akademik të përfshirë në mësimdhënie gjatë viteve 2012-2018, rezultojnë si më poshtë [Tabelat 7, Aneks]:

- për vitin **2017-2018**, personeli akademik përbëhet nga 8 pedagogë, nga të cilët **6 PAE dhe 2 PAK (75%/25%)**
- për vitin **2016-2017**, personeli akademik përbëhet nga 8 pedagogë, nga të cilët **4 PAE dhe 4 PAK (50%/50%)**
- për vitin **2015-2016**, personeli akademik përbëhet nga 8 pedagogë, nga të cilët **6 PAE dhe 2 PAK (75%/25%)**
- për vitin **2014-2015**, personeli akademik përbëhet nga 8 pedagogë, nga të cilët **5 PAE dhe 3 PAK (63%/37%)**
- për vitin **2013-2014**, personeli akademik përbëhet nga 7 pedagogë, nga të cilët **3 PAE dhe 4 PAK (43%/57%)**
- për vitin **2012-2013**, personeli akademik përbëhet nga 8 pedagogë, nga të cilët **3 PAE dhe 5 PAK (38%/62%)**

Gjatë periudhës 2012-2018, për vitet 2017-2018 dhe 2015-2016 stafi efektiv ka qenë mbi 70%. Për gjithë vitet e tjera kjo normë ka qenë në intervalin 38%-63%.

Referuar planeve mesimore dhe peshës së krediteve të mbuluara nga stafi akademik efektiv për profilin "Liderhip dhe Manaxhim Burimesh Njerezore", për dy vitet e para 58,3% e krediteve që plani mësimor i këtij profili përmban mbulohen nga staf efektiv. Për 4 vitet e fundit, kjo normë është në intervalin 75% - 91.7%.

**Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinatori i programit të studimit**

Të dhënat për këshillin shkencor të programit të studimit MPAB, me profile, paraqiten në Tabelën 2, shtojca bashkëlidhur. Referuar tabelës 2, Këshilli Shkencor i programit të studimit MPAB, me profile, përbëhet nga 3 pedagogë që janë staf efektiv dhe që i përkasin kategorisë "Profesor".

**Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre**

Të dhënat për kualifikimin e stafit dhe raportet midis tyre për programin "Master Profesional" në "Administrim Biznesi", për profilet paraqiten në Tabelën 8, Aneksi bashkëlidhur:

**Per profilin Finance-Banke** nga analiza e të dhënave për kualifikimin e stafit akademik të përfshirë në mësimdhënie gjatë viteve 2012-2018, rezultojnë si më poshtë:

- për vitin **2017-2018**, **88 %** e stafit të përfshirë përbëhet nga **stafi me tituj ose grade shkencore**
- për vitin **2016-2017**, **100 %** e stafit të përfshirë janë me tituj ose grade shkencore
- për vitin **2015-2016**, **75%** e stafit të përfshirë janë me tituj ose grade shkencore
- për vitin **2014-2015**, **89%** e stafit të përfshirë janë me tituj ose grade shkencore
- për vitin **2013-2014**, **88%** e stafit të përfshirë janë me tituj ose grade shkencore
- për vitin **2012-2013**, **100%** e stafit të përfshirë janë me tituj ose grade shkencore

Gjatë serisë kohore 2012-2018, kjo normë ka qenë në intervalin 75%-100% e stafit efektiv të përfshirë në mësimdhënie

**Per profilin Marketing dhe Manaxhim Operacionesh** nga analiza e të dhënave për stafin akademik të përfshirë në mësimdhënie gjatë viteve 2012-2018, rezultoi si më poshtë:

- për vitet **2017-2018, 2016-2017, 2015-2016, dhe 2014-2015** **100%** e stafit të përfshirë në këtë program studimi, përbëhet nga **stafi me tituj ose grade shkencore**
- për vitet **2013-2014 dhe 2012-2013** **83%** e stafit efektiv janë me tituj ose grade shkencore

Gjatë periudhës 2012-2018, norma e përfshirjes së stafit me tituj dhe grada, ka qenë në intervalin 83%-100% e stafit efektiv të përfshirë në mësimdhënie

**Per "profilin Lidërsip dhe MBNJ** nga analiza e të dhënave për kualifikimin e stafit akademik të përfshirë në mësimdhënie gjatë viteve 2012-2017, rezultoi si më poshtë:

- për vitin **2017-2018**, **75%** e stafit përbëhet nga stafi me tituj ose grade shkencore
- për vitin **2016-2017**, **75%** e stafit përbëhet nga stafi me tituj ose grade shkencore
- për vitin **2015-2016**, **72%** e stafit përbëhet nga stafi me tituj ose grade shkencore
- për vitin **2014-2015**, **88%** e stafit përbëhet nga stafi me tituj ose grade shkencore
- për vitin **2013-2014**, **72%** e stafit përbëhet nga stafi me tituj ose grade shkencore
- për vitin **2012-2013**, **75%** e stafit përbëhet nga stafi me tituj ose grade shkencore

Gjatë periudhës 2012-2018, norma e përfshirjes së stafit me tituj dhe grada ka qenë në intervalin 72%-88% e stafit efektiv të përfshirë në mësimdhënie

**Të dhëna sipas moshës së personelit**

Të dhëna për përbërjen moshore të stafit akademik, të përfshirë në këtë program studimi, paraqiten në *Tabelat 9 në shtojcë*. Për të gjithë periudhën e akreditimit, për tre profilet e PS MPAB, GVJ konstaton një shpërndarje të harmonizuar mes intervaleve moshore për staf akademik efektiv dhe staf akademik joefektiv

**Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat**

GVJ referuar dokumentacionit të vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni, informacionit të siguruar nga shqyrtimi i dosjeve të stafit, dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në UMB, konstaton se kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë të përfshira në Statut për nivelet e larta të drejtimit, nëni 28-30 i Statutit, ndërsa për stafin tjetër sipas nenit 23 të Statutit të UMB. Bordi miraton kriteret kryesore arsimore për stafin që rekrutohet. Ndërkohë kriteret propozohen në varësi të vendit vakant nga strukturat përkatëse. *[Evidence 2. viii a KONTRATA TIP TE BRENDSEHEM.pdf Dosja e vetëvlerësimit; 15. Procedure punesimi.pdf; 15.1 Punësimi Shpëtim Cami.pdf, vizita në institucion]*

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

- Procedurë punësimi, Punësimi SH.C., K.N., Procedurë rekrutimi.pdf – Dokumentat 16, 17, 37 & 38 nga Vizita në institucion.
- Ngarkesa e stafit të angazhuar në programin e studimit.pdf – Dokumentat 24 & 25 nga Vizita në institucion.
- Listë me temat e mikrotezave.pdf – Dokumentat 22 & 23 nga Vizita në institucion.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>GVJ, bazuar mbi takimet me stafin akademik të programit dhe nga informacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion vëren se, personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e PS MPAB me profile dhe për arritjen e tyre</p> <p>Personeli akademik angazhohet në përputhje me strategjinë për kërkim shkencor të institucionit.</p> <p>Përveç procesit mësimdhënies ata janë të angazhuar edhe në përfshirjen në veprimtari administrative dhe mbeshtetese.</p> <p>Gjithashtu gjate vizites ne institucion GVJ konstatoi nje angazhim te plote te stafit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrative te UMB, ne mbeshtetje te stafit akademik dhe studenteve te PS MPAB me profile</p>
<b>Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Gjate vizites ne UMB dhe takimeve me drejtuesen e njesise kryesore dhe njesive baze pergjegjese per PS MPAB me profile, rezultoi se çdo titullar lënde, ndërton syllabusin e lendes si dhe propozon ndryshimet e nevojshme për përmirësim e vazhdueshëm të lëndës.</p> <p>GVJ konstaton se në nivel departamenti, trajtohen dhe diskutohen problematikat dhe nxitet përmirësimi i programeve dhe kurrikulës. [Evidence, Procedura e ndryshimit te planit mesimor.pdf; Shembuj ndryshim silabusesh ne vite.pdf, Vizita në institucion]</p> <p>Bazuar në nevojat e institucionit dhe të PS MP AB me profile, rekrutimi i personelit dhe caktimi i ngarkesave mësimore respektive synon të bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. [Evidence , 8 Politika e ngarkeses.pdf, Vizita në institucion]</p>
<b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje</p>	<p>Referuar informacionit te siguruar nga dosja e vetevleresimit</p>



<p>me statutin dhe rregulloren;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>si dhe nga informacioni i siguruar gjate vizites ne zyren e BNJ te UMB, GVJ konstatoi se institucioni, ndjek procedura ligjore dhe transparente te rekrutimit te stafit akademik efektiv dhe joefektiv</p> <p>Referuar te dhenave ne tabelat 5, 6, 7 bashkelidhur ketij raporti, GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- në profilin Finance-Kontabilitet, gjate gjithë periudhës per te cilën akreditohet ky program studimi, stafi efektiv i perfshire ka qenë në intervalin 11%-67% e stafit te angazhuar ne mësimdhënie. Referuar planeve mesimore dhe peshës se krediteve te mbuluara nga stafi akademik efektiv per kete profil, per tre vitet e para, 38,3 % e krediteve qe plani mësimor i këtij profili përmban mbulohen nga staf efektiv. Per tre vitet e fundit te periudhës se akreditimit, kjo norme eshte 71.7%, 80%, 71,7%.</li> <li>- në profilin Marketing dhe Manaxhim Operacionesh, per vitet 2017-2018, 2016-2017 dhe 2015-2016 stafi efektiv ka qenë 100% e stafit te perfshire ne program. Për 3 vitet e tjera kjo normë ka qenë në intervalin 50%-67%. Sipas planeve mesimore dhe peshës se krediteve te mbuluara nga stafi akademik efektiv per kete profil, pesha e krediteve te mbuluara nga stafi akademik efektiv per te gjithë periudhën e akreditimit eshte mbi 75%.</li> <li>- ne profilin Lidershhip dhe Manaxhim Burimesh njerezore, gjate periudhes se akreditimit stafi efektiv ka qene 100% e stafit te angazhuar per vitet 2017-2018 dhe 2016-2017, ndersa per vitet e tjera kjo norme ka qene [38%-63%]. Sipas planeve mesimore dhe peshës se krediteve te mbuluara nga stafi akademik efektiv per kete profil, per dy vitet e para 58,3 % e krediteve qe plani mësimor i këtij profili përmban mbulohen nga staf efektiv. Per 4 vitet e fundit, kjo norme eshte ne intervalin 75% - 91.7%.</li> </ul> <p>Nga praktikat e siguruar ne isntitucion, GVJ konkludon se institucioni ndjek procedura transparente per vlerësimin e personelit. <i>[Evidence, 16.1 Skedë Për Vlerësimin E Pedagogëve Të Jashtëm Koordinatorja e performances.pdf; Komunikim ne lidhje me vleresimit e studenteve Njesia e cilesise UMB.pdf, Vizita ne institucion]</i></p> <p>Prane zyrës se Burimeve Njerezore GVJ, konstatoi se gjendet nje baze te dhënave te raporteve te rekrutimit te personelit ne kete PS si dhe e njoftimeve per vende vakante. <i>[Evidence Procedure punesimi Kejda Nuhu.pdf, Vizita ne institucion]</i></p>
<p><b>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore</p>	<p>Programi manaxhohet nga përgjegjesit perkates te njesise baze. Përgjegjesi i departamentit te Ekonomise dhe Finances ka titullin Prof. Dr., ndersa përgjegjesi i departamentit te</p>

<p>dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Biznes, Menaxhim e Turizem ka gradën doktor i shkencave.</p> <p>Kriteri 2 nuk aplikohet per PS MP AB</p> <p>GVJ konstaton nga analizat e tabelave 5, 6, 7, bashkelidhur ketij raporti si dhe CV e stafit ne sistemin e informacionit te ASCAL, se per gjithe periudhen e akreditimit, stafi me tituj dhe grada eshte ne intervalin 72%-100%. Stafi i angazhuar gjate ketyre viteve pa grade shkencore eshte ne intervalin 0%-18%, por referuar CV te tyre, ata kane një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi</p> <p>Referuar informacionit te siguruar ne institucion, gjithë drejtuesit në strukturën organizative, Rektori, Zv/Rektori, Dekani, Përgjegjësi i Pepartamentit dhe i programit, janë të punësuar me kohë të plotë në UMB</p> <p>Referuar vizitës në institucion, UMB, siguron personel te mjaftueshem për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>
<p><b>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Referuar takimeve me stafin akademik, me drejtuesit e njesive baze dhe asaj kryesore si dhe me studente te PS MP AB me profile, rezultoi se studentet kryesisht i nenshtrohen provimit, si aplikim i proves finale ne permbyllje te programit te studimit. Studentet te cilet kane mesatare te notave mbi 9, permbyllim studimet nepermjet mikrotezes.</p> <p>Referuar dokumentacionit te siguruar, rezultoi se studentet qe fitojne te drejten per te mbrojtur teme, kane nje udheheqes per punen e tyre kerkimore. [Evidence, 4. Liste me temat e mikrotezave 2016.pdf, Vizita ne institucion]</p> <p>Udheheqesit e mikrotezes rezultojne te kene se paku graden shkencore Dr.</p> <p>Referuar listave te ketyre temave, numri i studenteve qe ka cdo udheheqes eshte i limituar, duke qene se ka limit te mesatares per studentet qe mbrojne mikroteze . Nga takimet me drejtues te njesive baze pergjegjese dhe studentet e programit, kane te drejten te realizojne mikroteze, studentet me mesatare mbi noten 9. [Evidence, 4. Liste me temat e mikrotezave 2017.pdf, Vizita ne institucion]</p>
<p><b>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është</p>	<p>Nga të dhënat që iu vendosën GVJ në dispozicion, vërehet se pedagogët e angazhuar në këtë program studimi janë të specializuar në një fushë studimore-kërkimore, të njëjtë apo në përputhje me fushën studimore të këtij programi studimi.</p> <p>Këta pedagogë zotërojnë njohuri dhe aftësi të avancuara</p>

parashikuar të hartohet teza.	teorike dhe kërkimore në Marketing, Menaxhim, si dhe Finance dhe Kontabilitet [Evidence, Aneks/Shtojce CV të stafit akademik, Mp Administrim Biznesi me profile, Universiteti Marin Barleti; Liste me temat e mikrotezave 2017.pdf, Vizita ne institucion]
<b>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Pavarsisht se kurrikulat e te tre profileve te PS MP AB, nuk permbajne laboratore, por institucioni ka personel ndihmes te mjaftueshem dhe te angazhuar, per mirembajtjen e rrjetit dhe pajisjeve kompjuterike ne laboratorin e informatikes</p> <p>Gjate vizites ne institucion, GVJ konstatoi nje angazhim optimal te stafit administrativ, ne funksion te studenteve, te stafit akademik dhe te permbushjes se objektivave te ketij programi studimi.</p>
<b>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Referuar shperndarjes se ngarkeses për 2017-2018 qe GVJ siguroi gjate vizites ne institucion, konstatohet se stafi akademik efektiv mbulon numer te larte lendesh qe arrijne deri ne 7 lende te ndryshme dhe ne nivele te ndryshme studimi. [Evidence, 8..1 Ngarkesa e stafit te angazhuar ne programin e studimit 2017-2018.pdf, Vizita ne institucion].</p> <p>Nga dokumenti i shperndarjes se ngarkeses evidentohet se pervec numrit te larte te lendeve qe stafi akademik mbulon, vihet re se ka mosperputhje te fushes se ekspertizes dhe formimit akademik te stafit dhe lendeve qe mbulon. Këto lëndë përmbledhin një spektër të gjerë dhe të diversifikuar disiplinash. Kështu konstatohen raste kur ngarkesa e pedagogut eshte e shperndare ne mesimdhënie ne lende te ekonomiksit, te manaxhimit si dhe te finances, nderkohe qe specializimi i pedagogut eshte ne fushen e ekonomiksit. [Evidence, Aneks/Shtojce CV të stafit akademik, Mp Administrim Biznesi me profile, Universiteti Marin Barleti, Dosja e vetevleresimit]</p> <p>GVJ konstaton gjithashtu nje numer te larte lendesh deri ne 6 lende, edhe ne ngarkesen e stafit akademik qe mban pozicione drejtuese, si drejtues i njesise kryesore dhe drejtues i njesise baze, apo edhe stafit akademik qe mbulon detyra te tjera administrative.</p> <p>GVJ konkludon se UMB duhet te rishikoje numrin e lendeve/për 1 pedagog, numrin e lendeve/ për staf me detyra funksionale si dhe te rrise perputhshmerine mes fushes se ekspertizes se stafit akademik me llojin e disiplinave qe ata mbuojne.</p> <p>Referuar evidencës së ngarkesës që raportohet nga institucioni për dy vite, te siguruar nga vizita ne institucion, rezulton se ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në</p>

	<p>programin e studimeve MPMB, vlerësohen me orë mësimore [Evidence, 8..1 Ngarkesa e stafit te angazhuar ne programin e studimit 2017-2018.pdf, Vizita ne institucion]</p>
<p><b>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Referuar infomacionit të dosjes së vetëvleresimit dhe atij të siguruar nga vizita ne UMB, PS MP AB me profile, ka një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program [Tabelat 16-Plani mësimor]</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ siguroi listën e plotë të stafit akademik të angazhuar në cdo semester në këtë program studimi për 2017-2018 [Evidence, 8..1 Ngarkesa e stafit te angazhuar ne programin e studimit 2017-2018.pdf, Vizita ne institucion]</p> <p>UMB publikon kriteret për punësim në web sitin zyrtar.</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b></p>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ prane UMB, angazhohen për përmbushjen e objektivave të PS MPAB me profile</li> <li>- Personeli akademik ne UMB angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</li> <li>- UMB ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit dhe publikon njoftimet per vendet vakante. UMB disponon një bazë të dhënash te detajuar për personelin e tij.</li> <li>- Studentët që ndjekin PS MPAB me profile dhe qe plotesojne kufirin e notes mesatare, kanë nje udhëheqës për tezën. Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</li> <li>- Personeli ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i UMB eshte i angazhuar për përmbushjen e misionit të tij.</li> <li>- në profilin <i>Finance-Kontabilitet</i>, gjate periudhës per te cilën akreditohet ky program studimi, stafi efektiv i perfshire ka qenë në intervalin 11%-67% e stafit te angazhuar ne mësimdhënie. Per tre vitet e para, 38,3 % e krediteve qe plani mësimor i këtij profili përmban mbulohen nga staf efektiv. Per tre vitet e fundit te periudhës se akreditimit, kjo norme eshte respektivisht, 71.7%, 80% dhe 71,7%. Per profilin finance kontabilitet GVJ konkludon se UMB duhet te rrisë numrin e stafit efektiv te angazhuar ne mësimdhënie.</li> <li>- në profilin <i>Marketing dhe Manaxhim Operacionesh</i>, per vitet 2017-2018, 2016-2017 dhe 2015-2016 stafi efektiv ka qenë 100% e stafit te perfshire ne program. Për 3 vitet e tjera kjo normë ka qenë në intervalin 50%-67%. Pesha e krediteve te mbuluara nga stafi akademik efektiv ne kete profil per te gjithë periudhën e akreditimit eshte mbi 75%.</li> <li>- ne profilin <i>Lidership dhe Manaxhim Burimesh</i> njerezore, gjate periudhes se akreditimit stafi efektiv ka qene 100% e stafit te angazhuar per vitet 2017-2018 dhe 2016-2017, ndersa per vitet e tjera kjo norme ka qene 38%-63%. Per kete profil, per dy vitet e para 58,3 % e krediteve qe plani mësimor i këtij profili përmban mbulohen nga staf efektiv. Per 4 vitet e fundit, kjo norme eshte ne intervalin 75% - 91.7%.</li> <li>- Konstatohet se stafi akademik efektiv mbulon numer te larte lendesh qe arrijne deri ne 7 lende te ndryshme dhe ne nivele te ndryshme studimi.</li> </ul>	

- GVJ konstaton raste të mosperputhjes të fushes së ekspertizës dhe formimit akademik të stafit dhe lendeve që mbulojnë. Këto lëndë përmbledhin një spektër të gjerë dhe të diversifikuar disiplinash.
- GVJ konkludon se UMB duhet të rishikojë numrin e lendeve/për pedagog, numrin e lendeve/ për staf me detyra funksionale, si dhe të rrisë perputhshmerinë mes fushes së ekspertizës së stafit akademik me llojin e disiplinave që ata mbulojnë.

#### 4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

##### Pjesa përshkrimore

*Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.*

GVJ gjatë vizites në institucion, zhvilloi takime në dy kampuset që UMB ka në dispozicion të realizimit të programeve të studimit. Gjatë kësaj vizite dhe nga takimet me drejtues të institucionit, u konstatua se në kampusin 1 janë përqëndruar kryesisht studimet bachelor, administrata, biblioteka, laborator informatike etj. Në kampusin 2, zhvillohen kryesisht studimet master dhe programet e studimit në edukim fizik dhe sporte. Në dy kampuset, ka hapësira të mjaftueshme për salla leksionesh, laboratorë, zyra, hapësira parkimi, mjedise çlodhëse, hapësira të gjelbëra, hapësira të lira qarkullimi.

Në mbështetje të studentëve funksionojnë sekretarite, shërbimi i fotokopjeve, mensa, biblioteka, shërbimet për vetorganizimin studentor, zyra e alumnit dhe karrieres etj, Zyra e rekrutimit, Klinika e Këshillimit psiko-social etj.

##### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Mjediset për Programin e studimit (Tabelat 12 në Aneks)

Për të dhënat e infrastrukturës, GVJ iu është referuar tabelave të siguruar nga RVB pas verifikimit të tyre gjatë vizitës në institucion. Theksojmë se të dhënat infrastrukturave janë paraqitur në nivel institucioni dhe jo fakulteti/departamenti/programi [Tabela 12].

Referuar vizitës së ambjenteve të UMB, GVJ konstaton dhe vlerëson se institucioni, vendos në dispozicion të programeve të studimit të vet, në këto kuadër edhe në dispozicion të PS MPAB, infrastrukturën e duhur, me kapacitete të mjaftueshme, me teknologji të duhur në dispozicion të mësimdhënies, me kushte të duhura të ngrohjes, ndriçimit si dhe mbulimit me internet.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
  - Procedurë pasurimi e bibliotekës.pdf - Dokumenti 4 nga Vizita në institucion.

##### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;	GVJ konstatoi se aktiviteti i UMB, zhvillohet në dy kampuse, kampusi 1 ku zhvillohen aktivitetet administrative si dhe programet e studimit master, si dhe kampusi 2 ku zhvillohen programet master kryesisht dhe ato të edukimit fizik.
<b>Kriteri 2</b> Këto mjedise janë në dispozicion të	

<p>institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arrijtjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Mjediset ne dispozicion te programeve te studimit ne te dy kampuset, janë prone e aksionereve te UMB</p> <p>Pavarsisht se programi i studimit zhvillohet ne kampusin 2, ndërsa departamentet përgjegjëse per PS MP AB me profile, gjenden ne kampusin 1, GVJ eshte e mendimit se kjo nuk pengon ne zhvillimin efektiv te PS sepse, ne kampusin 2 gjenden sekretaritet master, zyra per stafin, biblioteka, ne shërbim te studenteve dhe stafit te programit.</p>
---	---

**Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Referuar takimeve me stafin e programit dhe me studentet e profileve te ndryshme, GVJ konstaton se institucioni, siguron tekste mesimore te pedagogeve efektiv, tekste te përkthyer, leksione te shtypura, materiale ndihmese etj. Ne shërbim te plotesimit te kërkesave per literature, eshte edhe UMB Press, duke qene nje mbështetje per botimet e mundshme te stafit akademik.</p> <p>Nga vizita e GVJ ne mjediset e bibliotekës, u konstatua se biblioteka disponon literature te mjaftueshme ne mbështetje te studenteve te PS MPAB, si botime tekstesh, periodikësh, ne mbështetje te lendeve qe PS përmban. Pjese e këtyre periodikeve eshte edhe revista Gjeopotika, e cila eshte organ i UMB.</p> <p>Ne dispozicion te studenteve janë edhe mundësitë e bibliotekës online e cila ka nje kapacitet te larte te librave, revistave dhe artikujve shkencore ne dispozicion te stafit dhe studenteve.</p> <p>Nga vizita ne institucion, GVJ konstatoi praktika te ndjekura nga drejtuesit e njësive baze, per kërkesa per shtimin e fondit ne biblioteke si dhe miratimi dhe realizimi i këtyre kërkesave nga zyra administrative përkatëse. [Evidence, 6- Procedure pasurimi i bibliotekes.pdf, Vizita ne institucion].</p> <p>Oraret e shërbimit te bibliotekes jane ne perputhje me nevojat e studenteve per akses ne biblioteke.</p>
--	--

**Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pajisjet e mjedisve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p>	<p>GVJ referuar te dhënave nga RVB si dhe vizitës ne ambjentet e dy kampuseve te UMB, konstaton se ne dispozicion te PS ka sasi te mjaftueshme te sallave te leksioneve/seminareve te pajisura me mjete audiovizive ne shërbim te mësimdhënies, si dhe zyra per aktivitetet administrative mbështetëse te PS [Tabela 12, shtojca]</p> <p>Keto mjedise GVJ i konsideron te përshtatshme per zhvillimin e proceseve mesimore, nga pikëpamja e pajisjes me PC, videoprojektore si dhe internet.</p> <p>GVJ konstaton se UMB ve ne dispozicion te studenteve te</p>
---	---

<b>Kriteri 4</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.	programeve te ndryshme te studimit 5 laboratore informatike.
<b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- GVJ mbështetur në dokumentacionin e dosjes së vetëvlerësimit, dokumentacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, vlerëson se UMB siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programit të studimit MPAB, me profile.</li> <li>- UMB disponon mjedise të përshtatshme mësimore te pajisura me mjete te teknologjisë se informacionit per te mbështetur programin e studimit MP AB me profile</li> <li>- Biblioteka e UMB, ka ne dispozicion te studenteve dhe stafit akademik te PS MP AB, literature te mjaftueshme, libra, revista shkencore dhe periodike te ndryshem te shtypur si dhe mundesi te shfrytëzimit e bibliotekes online.</li> </ul>	

## 5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

### Pjesa përshkrimore

*Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.*

Në këndvështrimin ligjor SHLUJ “Universiteti Marin Barleti” është e organizuar si një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar që zhvillon veprimtarinë e saj në fushën e arsimit të lartë (shoqëria tregtare “Marin Barleti” shpk). Bazuar në kërkesat e legjislacionit përkatës kjo shoqëri harton dhe publikon pasqyra financiare vjetore mbi aktivitetin e zhvilluar në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe në pajtim me ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare. Sipas nenit 41, pika c, të ligjit Nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar” çdo vit këto pasqyra duhet t’i nënshtrohen vlerësimit të audituesit ligjor për vërtetësinë dhe sinqeritetin e informacionit të paraqitur para publikimit të tyre.

Gjithashtu, si pjesë e grupit ekonomik të shoqërive tregtare “Dudaj”, shoqëria tregtare “Marin Barleti” shpk është objekt auditimi periodik nga audituesit e grupit “Dudaj”.

Pjesa kryesore e të ardhurave realizohet nga tarifat e shkollimit që paguajnë studentët të cilët zgjedhin të ndjekin studimet e tyre pranë SHLUJ UMB. Pjesa tjetër e të ardhurave realizohet nga grantet, aktivitetet e shërbimit, të konsulencës dhe të trainimit.

Informacioni financiar i paraqitur në RVB dhe i marrë gjatë vizitave nga GVJ është në nivel Institucioni dhe jo specifik për programin e studimit objekt i këtij vlerësimi.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

- Konsulenca, Shërbimet trainuese                      më pak se 6%
- Tarifat e shkollimit    93%
- Të tjera    më pak se 1%

Gjatë periudhës 2012-2017 mbi 93% e të ardhurave në nivel institucioni realizohet nga tarifat e shkollimit dhe më pak se 6% nga aktivitet trainuese dhe konsulence. Të ardhurat e tjera nuk janë në vlera të rëndësishme. Në Tabelën 13 të Aneksit që shoqëron këtë dokument paraqiten të ardhurat në përqindje në nivel institucioni në vite.

- Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Gjatë periudhës 2012-2017 rreth 75% e shpenzimeve të kryera në nivel institucioni janë për paga dhe detyrimet e lidhura me to. Shpenzimet operative (përfshirë infrastrukturë dhe amortizim) variojnë nga 17% deri në 21%. Në Tabelën 14 në Aneksë paraqiten shpenzimet në përqindje në nivel institucioni në vite.

Në SHLUJ “Universiteti Marin Barleti” menaxhimi i burimeve financiare realizohet nga funksionet e Kancelarit të Universitetit, Administratorit, Përgjegjësit të Financës dhe Financierit të Institucionit.

Gjatë vizitës përfaqësuesja e zyrës së financës deklaroi se pasqyrat financiare të shoqërisë i nënshtrohen çdo vit auditimit nga ekspertë financiarë dhe me kërkesë të pronarëve të shoqërisë kryhen edhe auditime të tjera me ekspertë të shoqërive të grupit “Dudaj”. Këto të fundit konsiderohen raporte auditimi konfidenciale dhe janë vetëm për përdorim të brendshëm. Aktualisht kosto vjetore për student vlerësohet 1’200 euro.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Të dhëna financiare.pdf - Dokumenti 5 nga Vizita në institucion
- Raport i jashtëm auditimi 2017.pdf – Dokumenti 20 nga Vizita në institucion.
- Pjesë nga raporti i auditimit të brendshëm.pdf – Dokumenti 42 nga Vizita në institucion

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Shoqëria tregtare “Marin Barleti” shpk harton dhe publikon pasqyra financiare vjetore mbi aktivitetin e zhvilluar në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe në pajtim me ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare. Gjatë vizitës dhe takimeve rezultoi se këto pasqyra i nënshtrohen auditimit nga ekspertë të jashtëm dhe të grupit “Dudaj”.</p> <p>Informacioni i paraqitur në pasqyrat financiare i referohet të gjithë institucionit si një njësi e vetme.</p> <p>Raporti i auditimit bën një vlerësim të organizmit të kontabilitetit dhe kontrollit të brendshëm të shoqërisë në përputhje me objektin e veprimtarisë së saj por jo sipas programeve apo ciklit të studimeve.</p>
<b>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Pasqyra e Performancës evidenton të gjitha të ardhurat e realizuara dhe të gjitha shpenzimet e kryera për periudhën ushtrimore në nivel institucioni. Gjatë vizitës në institucion, GVJ u njoh me një raport të thjeshtuar që analizonte shpenzimet e programit të studimit “Master profesional në Administrim Biznesi” sipas tre profileve aktive për vitin akademik 2017-2018.</p> <p>Investimet në infrastrukturë kanë krijuar kushte të nivelit bashkëkohor për procesin e mësimin dhe të kërkimit. Pasqyrat financiare dhe lidhja me grupin ekonomik “Dudaj” dëshmojnë për qëndrueshmëri dhe kapacitete financiare të kënaqshme për të</p>



ardhmen.

**Konkluzionet e vlerësimit:**

- GVJ konstatoi se SHLUJ “Universiteti Marin Barleti” është e organizuar si një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar dhe harton pasqyra financiare vjetore mbi aktivitetin e zhvilluar.
- Institucioni bën auditim vjetor të situatës financiare, organizmit të kontabilitetit dhe kontrollit të brendshëm në nivel institucioni nga ekspertë kontabilistë të miratuar dhe ekspertë të grupit ekonomik “Dudaj”.
- Nga analiza e dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se institucioni përgatit raporte të thjeshta të analizës së shpenzimeve sipas profileve të programit të studimit.
- Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer nga një kontabilist i miratuar dhe jo nga një auditues ligjor i regjistruar në regjistrin publik të Audituesve ligjorë.<sup>2</sup>

## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

### Pjesa përshkrimore

*Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësive të SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.*

Referuar vizites ne institucion si dhe informacionit te siguruar nga RVB, konstatohet se prane UMB Zyra e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë . Kjo zyre eshte krijuar me vendim të Rektorit Nr. 50, datë 7.05.2018, dhe ka autonomi vepruese dhe akses për te gjitha të dhënat në SHLUJ UMB.

Referuar RVB, Zyra e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë në SHLUJ “Universiteti Marin Barleti”[cit]: “Ka si qëllim të ndjekë vijimësinë e proceseve themelore që ndikojnë në realizimin e plotë të procesit akademik dhe në zhvillimin afatshkurtër e perspektiv të kurrikulave universitare te UMB, proceset themelore të vlerësimit të cilësisë dhe akreditimeve programore e institucionale, mbështetur në dokumentacionin ligjor të arsimit të lartë dhe aktet nënligjore të MASR dhe aktet e tjera nënligjore, vendimore e udhëzuese të strukturave qeverisëse të institucionit”

Pervec ZZHKC ne UMB funksionon dhe Komisioni i Sigurimit të Cilësisë qe është një organizëm i krijuar me vendim të Rektorit Nr. 38 , datë 6.03.2016 dhe qe funksionon në nivel institucioni. Komisioni është i përbërë nga 4 anëtarë dhe ka përgjegjësinë për të garantuar se SHLUJ UMB i plotëson standardet e cilësisë. Ky organizëm përgjigjet për politikën e vlerësimit dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të brendshëm të cilësisë. KSC i raporton drejtpërdrejtë Senatit të SHLUJ UMB.

Nga vizita ne institucion, GVJ identifikoi dhe funksionimin e nje strukture tjeter, qe eshte Keshilli i Vleresimit te Performances, i cili funksionon prej 1 viti, referuar ketu informacionit te siguruar nga koordinatoreja e ketij keshilli, gjate kesaj vizite. Ky keshill perbehet prej 6 anetaresh, te cilet jane staf akademik. [Evidence, Shenime gjate vizites\_Marin Barleti\_MP ne Ekonomi.pdf]. KVP bashkepunon me ZZHKC, per te siguruar informacion per stafin akademik dhe per te siguruar nje vleresim te performances se stafit akademik. Ky keshill eshte ne pozicion rekomandues per performancen e stafit akademik te UMB dhe rezulton se keto rekomandime ia drejton rektorit dhe pergjegjesve te njesive kryesore. Deri tani, sic rezulton nga takimi me koordinatoren e ketij keshilli, aktiviteti i tij ka qene i perqendruar tek vleresimi i performances se stafit akademik te jashtem.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

<sup>2</sup> Znj. E. T, hartuese e raportit të auditimit për vitin 2017, mban titullin kontabilist i miratuar sipas dokumentit të paraqitur.

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

Referuar informacionit të siguruar nga vizita në institucion, Zyra e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë realizon pyetësorë dy here në vit, në dy javët e fundit të çdo semestri. Niveli i anketimeve rezultoi të jetë 25% e studenteve të çdo programi. Këto anketime behen fizikisht, (jo elektronikisht), dhe përpunimi i tyre realizohet nëpërmjet MS-Excel, për të siguruar rezultatet për çdo program studimi, për çdo lende dhe çdo pedagog. Të gjithë pyetësorët përpunohen dhe rezultatet i paraqiten me shkrim Rektorit. Rezultatet e tyre bëhen pjesë e diskutimeve në Senat. Nga dokumentacioni i siguruar gjatë vizites në institucion, rezultoi se rezultatet u komunikohen pedagogëve individualisht. Studentët njoftohen në terma të përgjithshëm për rezultatet e vlerësimeve të tyre për çështje të përmirësimit të kurrikulave dhe të mësimdhënies.

- Të dhëna për anëtarët e NJSBC

Mbas njohjes me RVB si dhe takimit me përfaqësues të Zyres së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, rezultoi se ZZHKC ka në përbërje të saj 3 anëtarë [Tabela 15, shtojca bashkëlidhur]

- Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Zyra e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë ka përgjegjësi për organizimin e procesit të vetëvlerësimit nga njësitë akademike bazë si dhe të realizimit të pyetësoreve të studenteve mbi procesin mësimor dhe mësimdhënien; formulimin e mendimeve e propozimeve për plotësimin e standardeve të cilësisë në programet mësimore apo ato institucionale; t'i drejtohet drejtpërsëdrejti Rektoratit për informacione, njoftime, propozime, sinjalizime të detyrave në fushën e mësimdhënies dhe detyrimeve ndaj MASR dhe institucioneve partnere.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Vlerësimi i stafit akademik, modele.pdf - Dokumenti 7 nga Vizita në institucion
- Raport përmbledhës për vlerësimin e pedagogëve.pdf – Dokumentet 18, 19, 30 & 34 nga Vizita në institucion.
- Lista e veprimtarive të NJZHKC 2018.pdf – Dokumenti 34 nga Vizita në institucion.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <p>a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;</p>	<p>Nga takimi me përfaqësues të ZZHKC dhe studentet e programit, rezultoi se UMB përdor instrumenta matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programit të studimit [Evidence, 2. vii. Modeli i pyetësoreve të studenteve.pdf, Dosja e vetëvlerësimit]</p> <p>Konstatohet se rezultatet e këtyre instrumentave të përdorur, përfshihen në raportet që ZZHKC bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe për vlerësimin e performancës, në bashkëpunim me KSC dhe KVP.</p> <p>Rezultoi se UMB përdor mekanizma për t'i bërë publik rezultatet e vlerësimit të brendshëm, duke i diskutuar në senat por edhe duke u komunikuar stafit akademik të përfshirë në anketim [Evidence, 14.6 Komunikimi i rezultateve të anketave të studenteve tek pedagogët nga zyra</p>

<p>b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</p> <p>c. Pyetje konceptuale;</p> <p>d. Intervista; etj.</p> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <p>a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);</p> <p>b. Dëgjime në auditor;</p> <p>c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</p> <p>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</p> <p>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës; etj.</p>	<p><i>e performances.pdf, Vizita ne institucion]</i></p> <p>Referuar RVB, takimeve me studentet, takimet me perfaqesues te ZZHKC dhe KVP, GVJ konstaton se mekanizmat e perdorur per kryerjen e vleresimit jane:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Feedback nga studentët që ndjekin programin e studimit</li> <li>○ Feedback nga pedagogët</li> <li>○ Pyetësorë</li> <li>○ Rezultatet e studentëve në provime</li> <li>○ Rezultatet e arritura nga studentët në detyra kursi, projekte, punë individuale, punë në grup</li> <li>○ Vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës</li> <li>○ Rezultate të provës finale.</li> </ul> <p>GVJ eshte e mendimit, se UMB duhet te aplikojë edhe forma te tjera te vleresimit 360 grade, si forma te vetevleresimit, fokus grupe me studente, forma te vleresimit nga pergjegjesi I njesise baze etj.</p>
<p><b>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>GVJ nuk konstatoi praktika te publikimit te broshurave apo buletineve per vleresim nga institucioni.</p> <p>GVJ nuk identifikoi ne faqe prezantime interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>
<p><b>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>GVJ konstatoi se UMB realizon nje analize vjetore per vleresimin e programeve te studimit. <i>[Evidence, 14.3 Pjese Nga Raporti I Vleresimit Te Studenteve.Pdf , Vizita Ne Institucion]</i></p> <p>GVJ konstatoi se UMB ka hartuar politika dhe strategji ne lidhje me sigurimin e cilesise <i>[Evidence, 14.5 Pjese nga Stratgjia e sigurimit te cilesise.pdf]</i></p>
<p><b>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni përdor mekanizma formalë për</p>	<p>UMB është vlerësuar nga ekspertët e ASCAL në bashkëpunim me QAA për akreditimin institucional.</p> <p>Nga informacioni i siguruar, GVJ konstaton se UMB përdor disa mekanizma te ndryshem per sigurimin e brendshem te cilesise. ZZHKC, KSC, KVP jane te treja struktura te krijuara mbas 2016. GVJ eshte e mendimit se, institucioni duhet te harmonizojë si dhe te rakordoje veprimtarine e tre strukturave, per te mos shkaktuar mbivendosje te funksioneve te tyre, por si dhe per te siguruar nje vleresim</p>

<p>shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>te plote ne nivel programi studimi, nivel njesie baze, njesie kryesore si dhe institucioni.</p> <p>GVJ sugjeron qe institucioni te konsolidoje perdorimin e mekanizmave vleresues si dhe ti diversifikoje ato, duke realizuar vleresime 360 grade.</p> <p>UMB perdor mekanizma formale per shqyrtimin dhe mbikeqyrjen e herepashershme te programeve te studimit. Sipas RVB por edhe takimit me drejtues te njesise kryesore, rezulton se raportet analizohen ne njesine kryesore dhe problematikat e pergjithshme trajtohen ne mbledhjet e senatit.</p> <p>GVJ nuk konstatoi publikime te strategjise, politikave dhe procedurave per permiresimin e vazhdueshem te cilesise.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ne UMB funksionon zyra e zhvillimit te kurrikules dhe cilesise, Keshilli i vleresimit te performances si dhe Keshilli i Sigurimit te cilesise te cilat bashkerendojne aktivitetet per sigurimin e cilesise ne rang institucioni</li> <li>- UMB përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e PS MP AB me profile.</li> <li>- UMB kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve</li> <li>- GVJ eshte e mendimit, se UMB duhet te aplikoje edhe forma te tjera te vleresimit 360 grade, si forma te vetevleresimit, fokus grupe me studente, forma te vleresimit nga pergjegjesi i njesise baze etj</li> <li>- GVJ nuk konstatoi praktika te publikimit te broshurave apo buletineve per vleresim nga institucioni si dhe prezantime interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</li> <li>- GVJ eshte e mendimit se, institucioni duhet te harmonizojë si dhe te rakordojë veprimtarine e tre strukturave te reja, ZZHKC, KSC, KVP, per te mos shkakuar mbivendosje te funksioneve te tyre, por si dhe per te siguruar nje vleresim te plote ne nivel programi studimi, duke perdorur mekanizma te diversifikuar dhe efektive.</li> </ul>	

## POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

### 7. Programi i studimit, organizimi i tij

#### Pjesa përshkimore

*Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndëu/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj*

Programi i studimit “Master Profesional në Administrim Biznesi” i ofruar nga SHLUJ UMB në tre profile aktive: Financë-Kontabilitet, Marketing dhe Menaxhim Operacionesh, Lidërsip dhe Menaxhim Burime Njerëzore, synon ndërthurjen e njohurive teorike dhe praktike me qëllim përgatitjen e profesionistëve sipas specialiteteve të mësipërme, nisur nga kërkesat e tregut të punës në vendin tonë.




Objektivi është që përfundim të programit të studimit, studentët të zotërojnë formimin teorik dhe praktik të specializuar sipas profileve. Në funksion të këtij objektivi kurrikula e këtij programi studimi përfshin lëndë që mundësojnë thellimin e dijeve në fusha si menaxhimi i burimeve njerëzore dhe lidhshipi, në fushën e financës dhe kontabilitetit, në fushën e marketingut, etj. Programi synon që studentët në përfundim të studimeve të zotërojnë kompetencat të cilat janë të pasqyruara në Rregulloren e Studimeve të SHLUJ UMB.

Për të përfutuar diplomën në programin e studimit “Master Profesional në Administrim Biznesi” studentët duhet të realizojnë 60 kredite, të cilat mund të përbushen në 1 vit ose 2 semestra. Gjatë semestrit të parë zhvillohen 6 lëndë, ndërsa në semestrin e dytë zhvillohen 2 lëndë dhe kryhet praktika profesionale. Programi i studimit mbyllet me kryerjen e provës finale, e cila në varësi të rezultateve vjetore mund të realizohet me një provim ose me punim diplome për studentët me mesatare mbi 9 (mbrojtje e mikrotezës).

Studentët në fillim të semestrit informohen mbi lëndët që do të zhvillojnë nëpërmjet syllabuseve të përgatitura sipas standardeve të SHLUJ UMB.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit “Master profesional në Administrim Biznesi” me tre profilet e tij aktive: Financë-Kontabilitet; Marketing dhe Menaxhim Operacionesh; Lidhshipi dhe Menaxhim Burime Njerëzore; i është nënshtruar procedurës së vlerësimit paraprak të ASCAL, kur është hapur në bazë të VKM Nr. 564, datë 28.05.2009 dhe të Urdhërit Nr. 259, datë 12.05.2010 të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës. Akreditimi i parë është sipas Urdhërit Nr. 329 të MASH, datë 07.08.2012 . Qëllimi i programit të studimit “Master Profesional në Administrim Biznesi” me tre profilet e tij, është përgatitja e profesionistëve të specializuar sipas profileve.

Që prej vitit të parë në këtë program studimi janë regjistruar dhe diplomuar studentë vetëm në tre nga pesë profilet e synuara fillimisht. Nga RVB dhe takimet e realizuara gjatë vizitës në institucion rezultoi se në profilet “Shërbime Bankare e Financiare” dhe “Prona të Paluajtshme dhe Sigurime” ende nuk ka studentë të regjistruar apo të interesuar mjaftueshëm.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor;

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Në Tabelat 16 (16.1, 16.2 dhe 16.3) të Aneksit paraqitet Plani mësimor për vitin akademik sipas profileve dhe ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë.

Mënyra e përcaktimit të orëve për 1 kredit (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit.
- Për Seminaret 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit.
- Për Praktikën Profesionale 15 orë në auditor dhe 10 orë punë e pavarur e studentit.
- Provimi përfundimtar (Prova finale) 8 orë në auditor dhe 17 orë punë e pavarur e studentit.

Shpërndarja e orëve për 1 kredit (ECTS) sipas formave të studimit është në linjë me praktikën aktuale të përcaktimit të krediteve nga programe studimi të ngjashme.

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni, vizitat në institucion dhe informacionin shtesë të siguruar gjatë këtyre vizitave nuk konstatoi ndryshime në planet mësimore krahasuar me ato të licensuara për

vitet 2012-2018. Por për vitin akademik 2018-2019 parashikohet të ketë një ndryshim në planet mësimore, pas marrjes së miratimit nga MASR. Ndryshimi konsiston në rritjen e krediteve për praktikën profesionale nga 5 në 6 kredite (ECTS); pakësimin e krediteve për provën finale nga 15 në 11 kredite (ECTS); si dhe shtimin e një lënde të re me 3 kredite në të tre profilet e programit MP në AB, me titull “Marketingu dixhital”. Ky ndryshim prek më pak se 20% të planit mësimor të miratuar, ka marrë miratimin e Senatit Akademik të UMB dhe është në përputhje me kërkesat e ligjit 80/2015 dhe Udhëzimit Nr. 31 datë 29.12.2017 të MASR.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Tabelat 17 ne Aneks)

Në Tabelat 17 të Aneksit që shoqëron këtë dokument paraqiten planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës.

Bazuar në sa më sipër dhe CV e personelit akademik, GVJ konstaton se përgjithësisht mbulimi i lëndëve në secilin profil të programit të studimit MP në AB, nga personeli akademik është në përputhje me fushën e ekspertizës. Por në ndonjë rast, vihet re se ka mospërputhje të fushës së ekspertizës dhe formimit akademik të stafit dhe lëndës që ai mbulon (p.sh. mësimdhënie në lëndë të financës dhe menaxhimit, ndërkohë që specializimi/ekspertiza e pedagogut është në fushën e marketingut dhe ekonomiksit).

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Bazuar në dosjen përkatëse të programit të studimit MP në AB, GVJ konstaton se syllabuset e secilës prej lëndëve, sipas profileve janë të organizuara në mënyrë të qartë dhe të plotë. Cdo syllabus përmban informacionin e përgjithshëm dhe identifikues përkatës si emërtimi i lëndës, semestri kur zhvillohet lënda, titullari, ngarkesa në orë, tipologjia dhe kodi etj. Më pas vijon me objektivat dhe rezultatet e pritshme, konceptet kryesore dhe temat e parashikuara. Në syllabus përcaktohet qartë forma e kontrollit të dijeve dhe e vlerësimit të studentëve, detyrimet e studentit për lëndën, si dhe literatura e detyrueshme dhe ajo ndihmëse.

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Syllabuset e lëndëve në secilin prej profileve të Masterit Profesional në administrim Biznesi janë hartuar bazuar në eksperiencën e pedagogëve dhe përvojën më të mirë të krijuar nga bashkëpunimet me institucione homologe. Gjatë vizitës në institucion, në takimin me pedagogët, GVJ konstatoi se pedagogët cdo vit rishikonin syllabuset me qëllim pasqyrimin e ndryshimeve më të fundit në fushat përkatëse apo sipas nevojës së institucionit (por jo më shumë se 20% të syllabusit).

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Procedura e ndryshimit të planit mësimor.pdf - Dokumenti 1 nga Vizita në institucion.
- Shembuj ndryshimi syllabusesh në vite.pdf – Dokumenti 2 nga Vizita në institucion.
- Pyetsor mbi vrojtimin e tregut të punës.pdf – Dokumenti 9 & 10 nga Vizita në institucion.
- Studime tregu në vite.pdf – Dokumentet 26, 27 & 28 nga Vizita në institucion.

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p><b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi i studimit “Master Profesional në Administrim Biznesi” me tre profilet e tij ka marrë vlerësimin paraprak të ASCAL, kur është hapur në bazë të VKM Nr. 564, datë 28.05.2009 dhe të Urdhërit Nr. 259, datë 12.05.2010 të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës. Programi i studimit është i organizuar në lëndë mësimore, të cilat vlerësohen me kredite, në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit dhe</p>

	<p>Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Akreditimi i parë është sipas Urdhërit Nr. 329 të MASH, datë 07.08.2012 dhe VKA Nr.357, të datës 13.07.2012.</p> <p>Programi i studimit “Master Profesional në Administrim Biznesi” në secilin prej profileve të tij respekton kriterin e 60 krediteve në vit.</p>
--	--

**Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.**

<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 7</b> Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionalë, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi i studimit “Master Profesional në Administrim Biznesi” në secilin prej profileve të tij aktive u ofron studentëve që zotërojnë diplomën bachelor njohuri të thelluara teorike dhe praktike, si edhe trajnim profesional si gjatë zhvillimit të lëndëve përgjatë zhvillimit të pjesës teorike të masterit ashtu edhe përgjatë zhvillimit të praktikës profesionale gjatë semestrit të dytë të programit të studimit.</p> <p>Programi i studimit “Master Profesional në Administrim Biznesi” në secilin prej profileve të tij, bazohet në kurrikulën e nivelit bachelor në Ekonomi dhe Biznes të SHLUJ UMB dhe të kurrikulave bachelor të programeve të ngjashme të universiteteve homologe. Ky program synon zgjerimin dhe thellimin e njohurive të marra në nivelin bachelor.</p> <p>Programi i studimit “Master Profesional në Administrim Biznesi” pajis studentët me:</p> <p>(a) kompetenca të përgjithshme si aftësia për të punuar në grup, për të realizuar analiza dhe sinteza, për t’u organizuar dhe përshtatur, për të planifikuar, etj;</p> <p>(b) kompetenca specifike si aftësia për të interpretuar informacionin financiar dhe kuadrin rregullator, për të menaxhuar projekte dhe strategji, për të përdorur metoda dhe teknologji, etj;</p> <p>(c) kompetenca të transferueshme si aftësi në hartim raportesh, planesh, analizash, etj.</p> <p>Objektivat e programi të studimit “Master profesional në Administrim Biznesi” në secilin prej profileve të tij aktive, janë të qartë dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>
--	---

**Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.**

<p><b>Kriteri 1</b> Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Përmbajtja dhe objektivat e programit të studimit Master Profesional në Administrim Biznesi, në të tre profilet e tij aktive përputhen me nivelin e studimeve të ciklit të dytë. Kështu në aspektin e njohurive programi ofron njohuri të specializuara të fushave si menaxhimi i burimeve njerëzore dhe lidhshipi, financës, kontabilitetit dhe marketingut që shërbejnë si bazë për një menduar dhe kërkim origjinal, si edhe analizë kritike.</p> <p>Në aspektin e aftësive programi zhvillon aftësi për ekspertizë</p>
---	---

	<p>në zgjidhjen e problemeve sipas fushave të studimit të secilit profil. Në aspektin e kompetencave programi ofron kompetenca të përgjithshme, specifike dhe të transferueshme, duke mundësuar menaxhim dhe transformim të kontekstit të punës, qëndrim të pavarur dhe një performancë të kënaqshme të studentëve.</p> <p>Metodat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrolleve të vazhdueshme dhe periodike si testet e ndërmjetme, detyra apo projekte kursi, pjesëmarrje aktive në seminare dhe provimi përfundimtar dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve.</p>
<p><b>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Master Profesional në Administrim Biznesi, në secilin prej tre profileve të e tij aktive, është hartuar bazuar në përvojën më të mirë të krijuar nga pedagogët e angazhuar në program dhe bashkëpunimeve me universitetet e huaja me të cilat SHLUJ UMB ka lidhur marrëveshje.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në Administrim Biznesi, në secilin prej tre profileve të e tij aktive, paraqitet ndërkombëtarisht konkurrues për nga elementët që përmban si: të dhëna të përgjithshme, objektiva kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit të aplikantëve, metodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përmbyllje, etj. Programi i studimit Master Profesional në Administrim Biznesi, në secilin prej tre profileve të e tij aktive, është hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë.</p>
<p><b>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Administrim Biznesi, në secilin prej tre profileve të e tij aktive, synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara dhe aftësi profesionale në fushën përkatëse të profilit. Aftësimi praktik realizohet nëpërmjet disiplinës së praktikës profesionale dhe analizës së rasteve studimore konkrete përgjatë zhvillimit të lëndëve si dhe nëpërmjet detyrave/projekteve të kursit në to.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në Administrim Biznesi, është hartuar në përputhje me profilin e SHLUJ UMB dhe kërkesat statutorë të tij.</p> <p>Në dosjet personale të pedagogëve, në analizën vjetore të punës kërkimore-shkencore dhe në listën e të dhënave për kërkim shkencor të pedagogëve rezultojnë që personeli akademik angazhohet në punën kërkimore-shkencore në funksion të kualifikimit individual, në funksion të rritjes cilësore në mësimdhënie dhe përmirësimit të vazhdueshëm, në përshtatje me zhvillimet e fundit në fushën e programit të studimit.</p> <p>Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit Master Profesional në Administrim</p>



	Biznesi përkon edhe me synimet për arritjen e qëllimeve të këtij programi.
<b>Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Administrim Biznesi ofrohet në përputhje me nevojat e tregut të punës bazuar në një vlerësim të përgjithshëm dhe indirekt. Gjatë vizitës GVJ nuk konstatoi ndonjë studim tregu specifik të kryer posacerisht për nevojat e këtij programi studimi.</p> <p>Në secilin prej tre profileve aktive, programi i studimit Master Profesional në Administrim Biznesi synon të plotësojë nevojat specifike të secilit sektor në nivel kombëtar apo të huaj.</p>
<b>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar;</li> <li>kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</li> <li>numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</li> </ol>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Administrim Biznesi është hartuar në përputhje edhe me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik të vendit.</p> <p>SHLUJ UMB ka vlerësuar nevojat e tregut të punës bazuar në analiza dhe studime të kryera në përgjithësi për tregun vendas dhe rajonal, si dhe kërkesat e punëdhënësve. Gjithashtu ka përdorur të dhëna indirekte dhe të tjera mbi IAL të tjera që ofrojnë programe të ngjashme.</p> <p>Gjatë vizitës GVJ nuk konstatoi ndonjë studim tregu specifik të kryer posacerisht për nevojat e këtij programi studimi.</p>
<b>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Administrim Biznesi në të tre profilet e tij aktive, nuk bie ndesh me interesat kombëtare.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në Administrim Biznesi në të tre profilet e tij aktive synon ruajtjen e vlerave kulturore dhe kombëtare nëpërmjet përshtatjes së teorisë me praktikën dhe karakteristikat e vendit tonë.</p>
<b>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Administrim Biznesi në të tre profilet e tij aktive realizohet me 60 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja e programit të studimit është 1 vit akademik.</p>

<p><b>Kriteri 3</b> Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	
<p><b>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Studentët informohen që ditën e parë të studimeve, e në vijim sipas ecurisë, në lidhje me të gjithë elementët për të cilët janë të interesuar si: informacion në lidhje me programin e studimit, plani mësimor, syllabuset e lëndëve, rregulloret e masterit, etj. Studentët në lidhje me këta elementë kanë edhe mundësinë e konsultimit në faqen web të institucionit, portali i studentit.</p> <p>Informacioni në lidhje me të gjithë elementët e nevojshëm të programit të studimit ofrohet i printuar si broshurë apo fletëpalosje, si edhe elektronikisht në faqen web apo nëpërmjet prezantimit në leksione.</p>
<p><b>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Në rregulloren e studimeve të programit Master Profesional në Administrim Biznesi, përcaktohen kushtet dhe procedura e diplomimit. Rregullorja e mësipërme, në funksion të procesit të diplomimit, plotësohet dhe nga dokumentacioni Paketë e Provës Finale.</p> <p>Kriteri 2 nuk aplikohet në këtë program studimi.</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- GVJ konstaton se programi i studimit Master Profesional në Administrim Biznesi, në të tre profilet aktive të tij, ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit, si dhe me strategjinë e zhvillimit të SHLUJ UMB.</li> <li>- Ky program master bazohet në kurrikulën e bachelorit dhe është hartuar në përputhje me nivelin e studimeve master profesional.</li> <li>- Programi master në shqyrtim bazohet në përvojën më të mirë të pedagogëve të angazhuar në program dhe ekperiencën perëndimore të universiteteve me të cilat SHLUJ UMB ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.</li> <li>- Syllabuset e secilës prej lëndëve, të programit të studimit janë të organizuara në mënyrë të qartë dhe të plotë, përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor në nivelin e programit të studimit master profesional.</li> <li>- GVJ konstaton se përgjithësisht mbulimi i lëndëve në secilin profil të programit të studimit MP në AB, nga personeli akademik është në përputhje me fushën e ekspertizës.</li> <li>- Syllabuset e programit të studimit vlerësohen vit pas viti me qëllim përditësimi sipas ndryshimeve në fushat përkatëse si dhe për të reflektuar ndryshimet në tregun e punës, por GVJ nuk konstatoi ndonjë studim të mirëfilltë tregu të kryer posacërisht për nevojat e këtij programi studimi.</li> </ul>	

## 8. Mësimdhënia

### Pjesa përshkrimore

*Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.*

Në programin e studimit "Master Profesional në Administrim Biznesi" me tre profile mësimdhënia është e organizuar në formën e leksioneve, seminareve, përgatitje dhe prezantim i detyrave /projekteve të kursit, analizë e rasteve studimore, etj. Shpërndarja e ngarkesës në leksione dhe seminare në secilin prej tre profileve është përkatësisht 240 orë në auditor leksione dhe 60 orë në auditor seminare. Praktika profesionale si orë në institucion vlerësohet 75 orë në auditor, prova finale me 125 orë në auditor, për një total prej 600 orë në auditor për secilin profil (Tabela 18). Shpërndarja e ngarkesës në leksione dhe seminare në secilin prej profileve është në linjë me praktikën aktuale të programeve të studimit të ngjashme.

Kontrolli i njohurive kryhet nëpërmjet: testimit gjatë vitit dhe atij në fund viti, plotësimit të detyrimeve si detyra apo projekte kursi, si edhe aktivizimi i studentëve në seminare, etj. Për zhvillimin e mësimi në të gjitha lëndët e programit të studimit, institucioni ofron ambjentet e nevojshme ku mund të përdoret teknologjia në funksion të mësimdhënies.

Që prej muajit maj 2018 vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies kryhet nga Zyra e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, më parë realizohej nga njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë për nivelin master. Format e përdorura në vlerësim janë të shumëllojshme: anketime/pyetësorë të studentëve, vetëvlerësim i pedagogëve, etj. Gjithashtu studentët e programit të studimit Master Profesional në Administrim Biznesi nxiten të jenë pjesë aktive e veprimtarive kërkimore të departamenteve organizues dhe përgjegjës të programit të studimit dhe nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet (Tabela 18 ne aneks):

- Leksione
- Seminare
- Praktikë profesionale
- Provim përfundimtar ose punim diplome (nëse mesatarja është mbi 9)

Ngarkesa totale në auditor, përfshirë praktikën dhe provën finale, është 600 orë. Në Tabelën 18 të Aneksit që shoqëron këtë dokument paraqitet ngarkesa totale në auditor për format e mësimdhënies. Format e mësimdhënies të parashikuara janë në përputhje me nivelin e studimeve dhe në funksion të realizimit të objektivave të mësimdhënies të këtij programi studimi.

Format e kontrollit të njohurive

Kontrolli i njohurive të marra nga studentët në secilën lëndë të programit të studimit realizohet në disa forma: nëpërmjet vlerësimit të pjesëmarrjes aktive, vlerësimit të detyrave të kursit, tetsimeve gjatë vitit dhe provimit final. Në Tabelën 19 të Aneksit paraqiten format e kontrollit të njohurive. Format e kontrollit të njohurive janë në përputhje me nivelin e studimeve dhe eksperiencën bashkëkohore të programeve të studimit të ngjashme.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Gjatë vizitës të realizuar në Institucion, në takimin me studentët, GVJ konstatoi se studentët e programit të studimit Master Profesional në Administrim Biznes nxiten të marrin pjesë në projektet e ndryshme kërkimore që realizohen në nivel individual nga pedagogët e angazhuar në program, në nivel departamenti nga departamenti përgjegjës i profilit të programit të studimit apo në nivel Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë dhe më gjerë.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
- Politika e ngarkesës.pdf - Dokumenti 6 nga Vizita në institucion.

## 9. Studentët

### Pjesa përshkrimore

*Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.*

Procedurat e pranimit të studentëve në programin e studimit Master Profesional në Administrim Biznesi, në secilin prej tre profileve aktive të tij, janë të përcaktuara në rregulloren e studimeve të këtij programi. Sipas kësaj rregulloreje çdo kandidat duhet të zotërojë një diplomë universitare “Bachelor”, ose diplomë tjetër studimi të fituar brenda apo jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me të në fushën përkatëse ose në fusha që lidhen me programin për të cilin aplikohet.

Në rast se diploma bachelor nuk përputhet me fushën e profilit të programit të kërkuar, secili prej Departamenteve që mbulojnë profilet e studimit, vlerëson nëse kualifikimet dhe përvoja e kandidatit në fushë janë të mjaftueshme apo përcakton nëse kandidati duhet të realizojë një program përafrimi.

Bazuar në statistikat e Institucionit (Tabela 20) lidhur me studentët rezultojnë se që prej vitit të fillimit të këtij programi studimi e deri tani mesatarja e notës së studentëve në hyrje për të tre profilet varion nga 6.1 në 7.6. Ndërsa nota mesatare e rezultateve në programin e studimit për të tre profilet ka variuar nga 6.7 në 8.4.

Për të njëjtën periudhë kohore, vijueshmëria e programit të studimit deri në diplomën, brenda vitit akademik të regjistrimit, për të tre profilet varion nga 54%-66% e numrit të studentëve të regjistruar.

Gjithashtu Institucioni mban statistika të sakta në lidhje me punësimin e studentëve mbas përfundimit të studimeve master dhe komunikon me të gjithë studentët tashmë të diplomuar për t'i informuar në lidhje me mundësi punësimi, apo aktivitete të tjera, për të cilat ish-studentët mund të jenë të interesuar.

### Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve

Gjatë vizitës në institucion, në takimin me përfaqësuesit e sekretarisë mësimore u verifikuan ndër të tjera dosjet e 2 studentëve të diplomuar për secilin profil të programit të studimit dhe rezultoi se janë respektuar procedurat e pranimit të studentëve të parashikuar në rregulloren e këtij programi studimi.

- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Bazuar në statistikat e Institucionit (Tabela 20) lidhur me studentët rezultojnë se që prej vitit akademik 2012-2013 (viti i fillimit të këtij programi studimi) e deri në fund të vitit akademik 2016-2017,

- për profilin Financë- Kontabilitet nota mesatare e studentëve në hyrje është 6.8 ndërsa nota mesatare e rezultateve në programin e studimit është 8.2.
- Për profilin Marketing dhe Menaxhim Operacionesh nota mesatare e studentëve është 6.8 ndërsa nota mesatare e rezultateve në programin e studimit është 7.6.
- Për profilin Lidërsip dhe Menaxhim i Burimeve njerëzore nota mesatare e studentëve në hyrje është 6.9 ndërsa nota mesatare e rezultateve në programin e studimit është 8.

Bazuar në statistikat e Institucionit, GVJ konstaton një qendrueshmëri në cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve të këtij programi me një notë mesatare që lëviz në vlerat mesatare (7-8) për të tre profilet e programit të studimit të analizuar së bashku.

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Në Tabelën 20 të Aneksit që shoqëron këtë dokument paraqiten të dhënat sipas profileve lidhur me numrin e studentëve të diplomuar dhe notën mesatare të rezultateve në këtë program studimi. Gjatë periudhës 2012-2017 nota mesatare në diplomim e studentëve të diplomuar (pa vite përsëritëse) për të tre profilet e programit të studimit rezulton 8. Notën mesatare më të lartë e kanë studentët e diplomuar në profilin Financë-Kontabilitet rreth 8.14 dhe notën mesatare më të ulët e kanë studentët e profilit Marketing dhe Menaxhim Operacionesh me rreth 7.6 (të gjitha vitet së bashku).

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Nga verifikimi që iu bë regjistrave themeltar të programit të studimit, gjatë vizitës në institucion nuk rezultojnë transferime.

Të dhëna për punësimin e studentëve

Në Tabelën 21 të Aneksit që shoqëron këtë dokument paraqiten të dhënat sipas profileve lidhur me numrin e studentëve të punësuar në përfundim të këtij program studimi.

Numri total të diplomuarve (Tabela 20)

Gjatë periudhës 2012-2017 numri i studentëve të diplomuar për të tre profilet e programit të studimit rezulton 175 studentë . Përqindja më e lartë e diplomimit i takon profilit Financë-Kontabilitet rreth 79% dhe më e ulëta i takon profilit Lidërsip dhe Menaxhim i Burimeve Njerëzore me rreth 62% (të gjitha vitet së bashku).

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën/jo në përputhje me diplomën)

Nga statistikat e Institucionit rezulton se niveli i punësimit (vit pas viti si mesatare për të tre profilet) pas përfundimit të këtij programi studimi varion nga 61% -67% e të diplomuarve. Nga këta të diplomuar, rreth 60% janë të punësuar në përputhje me diplomën e marrë. Ky tregues është i njëjtë për secilin prej tre profileve të programit të studimit.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Dokumente nga zyra e pranimeve.pdf - Dokumenti 35 nga Vizita në institucion.
- Kriteret e pranimit në programet master zyra e pranimeve.pdf - Dokumenti 36 nga Vizita në institucion.

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin programet e studimeve "Master i Shkencave" apo "Master Profesional" zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë</p>	<p>Studentët që ndjekin programin e studimit Master Profesional në administrim Biznesi, në të tre profilet aktive të tij, zotërojnë diplomën universitare të nivelit të parë, bachelor, si dhe kanë grumbulluar 180 kredite. Në rregulloren e studimit të këtij programi studimi, kreu V neni 32 e</p>

<p>21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve "Master Profesional" niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve "Master i Shkencave" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni vlerëson herë pas here politikën e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>parashikon këtë element. Nga verifikimi me zgjedhje i dosjeve të dy studentëve për secilin profil të programit të studimit u konstatua respektimi i këtij kriteri.</p> <p>Studentët e programit të studimit Master Profesional në Administrim Biznesi, në të tre profilet aktive të tij, plotësojnë kriteret e pranimit të vendosura nga institucioni në kornizën e tij rregullatore.</p> <p>Kriteret e pranimit të studentëve janë të përcaktuara në rregulloren e këtij programi studimi dhe janë pjesë e rishikimeve në varësi të ndryshimeve të kryera në legjislacionin e arsimit të lartë, kërkesave të tregut të punës apo përmirësimit të standardeve të cilësisë së institucionit.</p>
<p><b>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikën e punësimit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Në SHLUJ UMB, studentëve ju jepet informacion për punësim pas diplomimit nga zyra e Alumni dhe zyra e Karrierës. Studentët janë pjesë e databazës së institucionit dhe informohen në lidhje me mundësi të ndryshme punësimi dhe aktivitete të tjera edhe pasi ka kaluar kohë nga diplomimi i tyre. Institucioni vazhdon e kryen këtë funksion për të përmirësuar pozicionet e punës së ish-studentëve. Informacionet afishohen nga këto zyra dhe në faqen web të institucionit.</p> <p>Studentëve ju jepet informacion në lidhje me akreditimin e institucionit dhe të programeve të veçanta të studimit që ai ofron nga zyra e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë. Kjo zyrë jep edhe informacionin në lidhje me procedurat e njohjes dhe vlefshmërisë së diplomave brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Shërbimi i këshillimit të karrierës ofrohet nga zyra e Alumni dhe zyra e Karrierës.</p>
<p><b>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Institucioni SHLUJ UMB mban dhe përpunon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programin e studimit Master Profesion në Administrim Biznesi, në secilin prej tre profileve aktive të tij.</p> <p>SHLUJ UMB mban dhe përpunon statistika vjetore për numrin e të regjistruarve në programin e studimit Master Profesion në Administrim Biznesi, në secilin prej tre profileve aktive të tij. Gjithashtu institucioni regjistron tërheqjet e studentëve nga programi apo mospërfundimet me sukses të vitit akademik, etj.</p> <p>Institucioni ndjek dhe regjistron ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri diplomim dhe më pas ndjek</p>

	edhe punësimin e studentëve në tregun e punës. Këto të dhëna disponohen dhe përpunohen nga sekretaria mësimore e studimeve master.
<b>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>SHLUJ UMB mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimit të ciklit të dytë si dhe vendet në të cilat ata janë punësuar.</p> <p>SHLUJ UMB bashkëpunon me Clemson university për studimet e ciklit të tretë që ky universitet ofron në Shqipëri. Në kuadër të këtij procesi bashkëpunimi SHLUJ UMB ka krijuar dhe mban një bazë të dhënash për studentët që ndjekin këto studime.</p>
<b>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Studentët e programit të studimit Master Profesional në Administrim Biznesi informohen nga personeli akademik përkatës dhe sekretaria mësimore për të gjitha detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor apo me elementë të tjerë ndihmës në funksion të këtij procesi.</p> <p>Konkretisht ata informohen në lidhje me: programin e studimit, strukturën e vitit akademik, statusin e akreditimit të programit, kuadrin rregullator të programit të studimit, etj. Disa nga informacionet e mësipërme janë pjesë e faqes web të institucionit.</p> <p>Studentët informohen në lidhje me rezultatet e vlerësimit gjatë programit dhe në përfundim të tij, nga pedagogët përgjegjës dhe nga sekretaria mësimore.</p> <p>Pedagogët e lëndës ju komunikojnë studentëve dhe diskutojnë me ta rezultatet e vlerësimeve të bëra gjatë dhe në fund të semestrit. Të drejtat e studentëve në lidhje me këtë element përcaktohen edhe në rregulloren e programit të studimit.</p>
<b>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>SHLUJ UMB këshillon studentët në lidhje me procesin mësimor, mbi të gjithë elementët për të cilët studentët janë të interesuar, asiston studentët në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që ata hasin gjatë programit të studimit. Ky shërbim këshillimit realizohet nga zyra e Alumnit dhe Karrierës, nga secili departament dhe nga secili pedagog i departamentit.</p> <p>Nëpërmjet zyrës së Alumnit dhe Karrierës si dhe me ndihmën e kordinatorit të programit të studimit, SHLUJ UMB ndihmon studentët të përzgjedhin institucionin apo shoqëritë ku do të zhvillojnë praktikën profesionale.</p>

### **Konkluzionet e vlerësimit:**

- GVJ konstaton se SHLUJ UMB respekton legjislacionin në fuqi dhe rregulloren përkatëse lidhur me regjistrimet e studentëve në nivelin master të këtij programi studimi.
- Institucioni informon studentët në lidhje me të gjithë elementët e nevojshëm për këtë program studimi, statusin e programit të studimit, të vetë institucionit si dhe me politikën e punësimit.
- Institucioni mban një bazë të plotë të dhënash në lidhje me studentët për elementë si: cilësia e tyre në hyrje, ecuria e tyre përgjatë studimeve, cilësia e tyre në dalje, punësimi i tyre, etj.
- Personeli akademik dhe ndihmës është i angazhuar në përkujdesjen ndaj studentëve.

## **KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.**

### **10. Kërkimi shkencor**

#### **Pjesa përshkrimore**

*Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësjia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.*

Politika e kërkimit shkencor dhe struktura të posaçme të kërkimit si Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit "Barleti" (BIRD), Instituti Shqiptar për Çështje Publike (AIPA) dhe Instituti i Edukimit Barleti (IEB) të SHLUJ UMB janë në shërbim edhe të programit të studimit në shqyrtim. Staf i akademik i programit të studimit realizon punë kërkimore-shkencore kryesisht si staf i angazhuar pranë instituteve, departamenteve, si lektorë apo koordinatorë projektsh kërkimore. Një ndër objektivat kryesorë në fushën e kërkimit shkencor, është realizimi i kërkimeve cilësore në fushat e veprimtarisë që ata mbulojnë, në bashkëpunim edhe me pedagogë të IAL të tjera brenda dhe jashtë vendit, si edhe me ekspertë të fushës.

Politika e kërkimit shkencor të SHLUJ UMB realizohet në përputhje me standardet e EQUIS në kategoritë e: kërkimit akademik të bazuar në metodologjitë bashkëkohore; kërkimit të orientuar drejt praktikës të bazuar në vëzhgime të thelluara të situatave komplekse e rasteve studimore; zhvillimit dhe inovacionit teknologjik lidhur me mjetet dhe teknikat e mësimdhënies. Aktiviteti kërkimor i institucionit në fushën e botimeve përfaqësohet nga studimeve dhe hulumtime të botuara në revistën "Gjeopolitika" si dhe artikuj të botuar në revista të tjera shkencore brenda dhe jashtë vendit, etj.

SHLUJ UMB informon studentët në lidhje me kërkimet më të fundit të realizuara nga pedagogë të institucionit dhe nxit përfshirjen e studentëve në projektet kërkimore sipas programeve të studimit ku bëjnë pjesë. Gjithashtu institucioni informon studentët për mundësitë që ofrohen për kualifikimin e tyre nga universitete dhe institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit dhe i mbështet studentët në procesin e tyre të aplikimit në këto institucione.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Të dhëna për kërkimin shkencor (Tabela 22 ne aneks)

Bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni, vizitat në institucion dhe informacionin shtesë të siguruar gjatë këtyre vizitave, GVJ konstatoi se të gjithë pedagogët e përfshirë në programin e studimit në shqyrtim janë të përfshirë në forma të ndryshme të kërkimit shkencor. Ky angazhim është në nivel institucioni, si pjesë e kualifikimit individual të personelit akademik dhe e projekteve kërkimore të organizuara në nivel fakulteti apo universiteti dhe GVJ nuk konstatoi ndonjë studim specifik të lidhur me programin e studimit MP në AB. Në



Tabelën 22 të Aneksit që shoqëron këtë dokument paraqiten të dhënat sasiore për kërkimin shkencor në nivel institucioni në vite.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
- Evidenca kualifikime stafi.pdf – Dokumenti 8 nga Vizita në Institucion.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Personeli akademik i programit të studimit Master Profesional në Administrim Biznesi është i angazhuar në publikimin e artikujve dhe merr pjesë në konferenca dhe aktivitete të tjera shkencore.</p> <p>Nëpërmjet angazhimit në veprimtari apo aktivitete të ndryshme shkencore personeli akademik i këtij programi studimi jep kontributin e tij në fushën e administrimit të njësive ekonomike publike dhe private.</p>
<b>Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Administrim Biznesi në të tre profilet aktive të tij organizohet në gjuhën shqipe.</p> <p>Megjithatë nga dosja me CV-të e personelit akademik të angazhuar në program, rezulton se ka pedagogë me eksperiencë mësimdhënie në gjuhë të huaj pranë universiteteve me të cilat SHLUJ UMB ka marrëveshje bashkëpunimi.</p>
<b>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>SHLUJ UMB nëpërmjet Institutit të Edukimit Barleti dhe Prorektorit për kërkimin shkencor dhe studimet pasuniversitare, organizon trajnime të stafit akademik me fokus metodat bashkëkohore të mësimdhënies, për hartimin e programeve lëndore, prirjet e zhvillimit në arsimin e lartë etj. Stafit akademik ka përfituar edhe nga trainime të posacme të organizuara nga Projekti Tempus, QainAL dhe Lektoriume me ekspertë të fushave të ndryshme.</p> <p>SHLUJ UMB ka mbështetur stafin akademik në aplikimin dhe ndjekjen e kualifikimeve dhe pjesëmarrjen në konferenca/trainime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.</p>
<b>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p>	<p>SHLUJ UMB disponon të dhëna për studime shkencore të personelit akademik të këtij programi studimi.</p>

<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p>	<p>SHLUJ UMB disponon të dhëna për botimet shkencore brenda dhe jashtë vendit të personelit akademik të këtij programi studimi. Baza e të dhënave përfshin kopje të botimeve si tekste, artikuj apo libra konference (pjesë e dosjes personale të pedagogëve).</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>SHLUJ UMB disponon të dhëna për projektet shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë aktualisht personeli akademik i këtij programi studimi.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- GVJ konstaton se personeli akademik i këtij program studimi është i angazhuar në kërkimin shkencor në funksion të kualifikimit të mëtejshëm dhe përmirësimit të procesit mësimor.</li> <li>- Nga dokumentacioni i paraqitur rezultoi se nëpërmjet politikave të sponsorizimit, institucioni mbështet stafin akademik për pjesëmarrje në konferenca, trajnime, etj, të organizuara nga SHLUJ UMB apo institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit.</li> <li>- Institucioni mban një bazë të dhënash lidhur me pjesëmarrjen në konferenca shkencore dhe botimet e realizuara nga personeli i tij akademik, brenda dhe jashtë vendit.</li> </ul>	

## 11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

### Pjesa përshkrimore

*Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.*

Politika e bashkëpunimit me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar e SHLUJ UMB është në funksion të realizimit të objektivave të programeve të studimit. Marrëveshje dhe memorandume bashkëpunimi janë lidhur me IAL shqiptare, universitete të rajonit si edhe me të universitete tjera të huaja. Marrëveshjet kryesisht kanë synuar bashkëpunimin në fusha me interes të përbashkët, angazhimin në aktivitete që lidhen me edukimin dhe zhvillimin e karrierës profesionale, hartim kurrikule të programeve të studimit, asistencë në përmirësimin e vazhdueshëm të saj, etj. Gjithashtu SHLUJ UMB ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe me komunitetin e biznesit si shoqëri tregtare, banka, shoqëri konsulence si dhe me institucione shtetërore, në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale në fund të programit të studimit dhe zhvillimit të aktiviteteve të tjera me interes reciprok.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (Tabelat 23 dhe 24 ne aneks)

Në Tabelën 23 të Aneksit që shoqëron këtë dokument paraqiten të dhënat për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar në nivel institucioni. Marrëveshjet e bashkëpunimit të paraqitura janë me institucione homologe, universitete të rajonit por edhe më gjerë dhe kanë për objekt rritjen institucionale dhe bashkëpunimin reciprok në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

Në Tabelën 24 të Aneksit që shoqëron këtë dokument paraqiten të dhënat për komunikimin dhe bashkëpunimin me institucionet e tjera në nivel institucioni. Marrëveshjet e paraqitura në këtë tabelë u referohen kryesisht bashkëpunimeve në funksion të realizimit të praktikave profesionale dhe mësimore për të gjithë studentët e programit master të SHLUJ UMB, por jo vetëm. Profili i institucioneve, organizmave dhe shoqërive të ndryshme me të cilat janë lidhur këto marrëveshje është në përputhje edhe me objektivat e synuara të këtij programi studimi.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion:
- Lista e studentëve ku kanë bërë praktikën LMBNJ.pdf – Dokumenti 29 nga Vizita në Institucion.
- Lista e praktikave profili financë-kontabilitet.pdf – Dokumenti 41 nga Vizita në Institucion.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Për kryerjen e praktikave profesionale si pjesë e programit të studimit Master Profesional në Adminstrim Biznesi, SHLUJ UMB ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe sipërmarrje të ndryshme si: shoqëri tregtare, banka, shoqëri konsulence dhe institucione shtetërore.</p> <p>GVJ vlerëson se profili I institucioneve dhe sipërmarrjeve të ndryshme me të cilat SHLUJ UMB ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e praktikave profesionale përputhet me objektivat e programit të studimit MP në AB.</p>
<b>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Në funksion të mbikëqyrjes dhe përmirësimit të vazhdueshëm të programit të studimit Master Profesional në Adminstrim Biznesi, SHLUJ UMB nxit bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit, ndërmjet personelit dhe hallkave institucionale brenda tij.</p> <p>SHLUJ UMB nëpërmjet ndarjes së detyrave dhe përgjegjësiive ndërmjet personelit dhe hallkave të ndryshme të institucionit, si dhe analizës së vazhdueshme të punës së gjithë secilit, garanton marrëdhënie të mira bashkëpunimi.</p>
<b>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkëpunim me punëdhënësit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>SHLUJ UMB për të realizuar objektivat e programeve të tij të studimeve ka nënshkruar marrëveshje dhe memorandume bashkëpunimi me IAL jashtë vendit (në rajon dhe më gjerë) dhe me IAL vendase. Disa prej tyre: Universiteti Arkansas, Clinton School, SHBA; Universiteti Clemson, SC, SHBA; Universita degli Studi, Genova, Itali; Universita degli Studi, Roma 3, Itali; Universiteti i Udines, Itali; Univesriteti per Biznes dhe Teknologji i Prishtinës; Universiteti Shtetëror I Tetovës; etj.</p> <p>SHLUJ UMB ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione vendase si Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit; Drejtoria e Doganave dhe dhe sipërmarrje private si Banka Credins, Century 21, DM Consulting Services etj për kryerjen e praktikës profesionale nga studentët.</p> <p>Marrëveshjet e sipërcituara përfshijnë edhe bashkëpunimin për</p>

organizimin e aktiviteteve të përbashkëta të tilla si prezantime apo leksione të hapura.

Megjithëse nuk ka një raport të posaçëm analize për marrëveshjet e bashkëpunimit, gjatë vizitës dhe takimeve me përfaqësuesit e Institucionit GVJ konstatoi se analiza e ecurisë së marrëveshjeve ekzistuese dhe nënshkrimet e marrëveshjeve të reja ishin pjesë e raportit vjetor të punës së vitit akademik, i cili diskutohet në të gjitha hallkat funksionuese në SHLUJ UMB.

**Konkluzionet e vlerësimit:**

- GVJ konstatoi se SHLUJ UMB ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me biznese vendase, me institucione financiare, me institucione shtetërore etj për kryerjen e praktikave profesionale të studentëve.
- Ky bashkëpunim realizohet jo vetëm në funksion të kryerjes së praktikave mësimore në përfundim të procesit mësimor por edhe për të konkretizuar më mirë dhe krijuar një lidhje me të fortë ndërmjet teorisë së zhvilluar në auditor dhe eksperiencës së përfituar në praktikë.
- Marrëveshjet e bashkëpunimit të SHLUJ UMB nuk kufizohen vetëm në sipërmarrjet dhe institucionet brenda territoreve të vendit por përfshijnë edhe institucione homologe të huaja.

## ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT MP AB ME PROFILE

### **I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË**

Referuar Vendimit të akreditimit të parë për PS MP AB, me profile pranë Universitetit "Marin Barleti", janë dhënë disa rekomandime. Bazuar në këto rekomandime, Universitetit "Marin Barleti" ka punuar drejt plotësimit të tyre në vazhdimësi. Nga tërësia e rekomandimeve të lëna nga procesi i akreditimit të parë, dhe nga ajo që GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacionit të ofruar mund të themi se:

**Për programin e studimit Master Profesional në Administrim Biznesi me profil: "Financë Kontabilitet".**

	<b>Rekomandimet nga akreditimi i parë</b>	<b>Statusi aktual</b>
a.	Të realizohet përmirësimi i menjëhershëm i raportit pedagog i brendshëm/pedagog i jashtëm.	Permbushur Pjesërisht
b.	Fakulteti/Departamenti duhet të shoh me përparësi përfshirjen e stafit të brendshëm të kualifikuar në organizimin e këtij programi studimi.	Permbushur Kryesisht
c.	Të rishikohen disa syllabuse në mënyrë që literatura bazë apo ndihmëse të jenë të up-datuara sipas kërkesave bashkohore .	Permbushur Plotesisht
d.	Të rishikohet rregullorja e provimeve, ku provimet të mos korrigjohen të pa sekretuara dhe vetëm nga një pedagog i cili është titullar i lëndës.	Permbushur Plotesisht
e.	Institucioni duhet të ketë në prioritetet dhe strategjitë e tij afatmesme, kërkimin shkencor, në mënyrë që të kompletojë stafin akademik të brendshëm në proceset e kualifikimit në mënyrë që brenda një kohe të shkurtër ky staf të përfshihet në procesin e mësimdhënies.	Permbushur Kryesisht
f.	Të synohet botimi i një reviste/buletini shkencor si edhe të aplikohen mënyra nxitëse ndaj stafit për botime shkencore dhe aktivitete shkencore si seminare dhe konferenca për gjallërimin e jetës shkencore si edhe ngritjes nga kjo edhe të kualifikimit e cilësisë së mësimdhënies.	Permbushur Plotesisht

**Për programin e studimit Master Profesional në Administrim Biznesi me profile: "Marketing dhe Menaxhim Operacionesh"; "Lidership dhe Menaxhim burimesh njerëzore".**

	<b>Rekomandimet nga akreditimi i parë</b>	<b>Statusi aktual</b>
a.	Të krijohen mundësia për akses në biblioteka elektronike për të siguruar suport për kërkim shkencor cilësor.	Permbushur Plotesisht
b.	Të përmirësohet raporti pedagog efektiv/pedagoge të jashtëm.	Permbushur Pjesërisht

**ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).**

**a. Pika të forta:**

- Strukturë organizative efektive në shërbim të programit të studimit.
- Përfshirje e lartë e stafit akademik me tituj dhe grada në të tre profilet e PS MP në AB.
- Mundësi shfrytëzimi të bibliotekave on-line përveç librave dhe revistave shkencore.
- Imazhi pozitiv, i krijuar tek studentët që kanë mbaruar programin e studimit MP AB me profile.
- Staf administrativ efektiv dhe i përkushtuar.
- Infrastruktura moderne dhe eficiente në shërbim të këtij programi studimi.
- Bashkëpunimi me institucione të administratës publike dhe organizata private.
- Mbështetja financiare nga grupi ekonomik "Dudaj".

**b. Pika të dobëta:**

- Numri i ulët i stafit efektiv të përfshirë në program.
- Numri i lartë lëndëve për pedagog në PS MP në AB.
- Raste të mospërputhjes së fushës së ekspertizës së stafit akademik me profilin e lëndëve që ata mbulojnë në PS MP në AB.
- Mungesë balance mes ngarkesës në mësimdhënie, detyrave administrative dhe kërkimit shkencor.
- Politike marketing e pamjaftueshme për të aktivizuar edhe profilet e tjerë të PS MP në AB.
- Mungesa e një studimi të mirëfilltë tregu dhe nevojave që ky treg ka për të diplomuar në profilet e PS MP në AB.

**c. Mundësitë:**

- Bashkëpunimi në rritje me institucionet shqiptare dhe të huaja për zhvillimin e kërkimit shkencor.
- Interesimi në rritje i shoqërive private dhe organizatave publike, për të rekrutuar studentët cilësorë.
- Rritja e mobilitetit të studentëve, e financuar nga BE nëpërmjet projektit Erasmus+.
- Mundësi angazhimi e pedagogëve joefektiv nga universitete të tjera në vend.

**d. Pengesat:**

- Ndryshimet e shpeshta të kuadrit ligjor, krijojnë problem në përshtatjen e institucioneve arsimore.
- Rreziku i krijimit të një hendeku ekspertize për shkak se një pjesë e stafit akademik me tituj është afër moshës së pensionit.
- Mos kryerja e auditimit financiar nga një auditues ligjor i regjistruar në regjistrin publik përkatës sjell mospajtueshmëri ligjore.

**Rekomandimet**

GVJ mbeshetur mbi të dhënat e analizuara për cdo standard, mbi konkluzionet e nxjerra për cdo fushë të këtij raporti si dhe në pikat e dobëta të identifikuar më sipër, rekomandon që SHLUJ UMB:

- a. Të rrisë numrin e pedagogëve efektivë të përfshirë në mësimdhënie në këtë PS.
- b. Të zvogëlojë numrin e lëndëve/për pedagog në PS MP në AB.
- c. Të zvogëlojë numrin e lëndëve/për stafin drejtues.
- d. Të rrisë përputhshmërinë mes fushës së ekspertizës së stafit akademik me llojin e disiplinave që ata mbulojnë.
- e. Të përdorë mekanizma të diversifikuar si dhe të intensifikojë politikën marketing për të aktivizuar edhe profilet: "Shërbime Bankare dhe Financiare"; "Prona të Paluajtshme dhe Sigurimi".
- f. Të realizojë një studim të mirëfilltë të tregut dhe nevojave që ky treg ka për të diplomuar në profilet e PS MP në AB.
- g. Të realizojë auditimin e pasqyrave financiare nga auditues ligjorë të regjistruar në regjistrin publik dhe të bëjë analiza më të plota të kostove sipas programeve të studimit.

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm**

Prof. Asoc. Dr. Etleva Leskaj

Dr. Valbona Kapllani